

MARTESAT E HERSHME NË SHQIPËRI

Një vështrim Specifik i Komunitetit Rom



Shkurt, 2015

Activity supported by the
Canada Fund for Local Initiatives
Activité réalisée avec l'appui du
Fonds canadien d'initiatives locales

Canada



Mbeshtetur nga Fondi Kanadez per Iniciativat Lokale

© 2015 Observatori për të Drejtat e Fëmijëve

ISBN: 978-9928-114-53-2

Printuar nga: Shtypshkronja “Natyra”

OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

“Observatori për të Drejtat e Fëmijëve” u themelua në vitin 2009 me mbështetjen dhe inkurajimin e organizatës ndërkombëtare UNICEF. Përvoja e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve prezantohet për herë të parë në shoqërinë Shqiptare dhe synon të funksionojë si një strukturë vëzhguese, e mbështetur në nivel lokal, në lidhje me zbatimin dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve, duke vepruar dhe ofruar mbështetje si pjesë e shoqërisë civile. Observatori ka për qëllim nxitjen e përpjekjeve dhe reformave në nivel qendror dhe lokal, në zbatim të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

Nëpërmjet përfaqësuesve të saj në nivel rajonal dhe në bashkëpunim me njësitë vendore në bashki dhe komuna, Observatori mbledh informacion mbi të dhënat nga rekordet administrative të shëndetit, arsimit, mbrojtjes sociale dhe autoriteteve të tjera lokale. Nëpërmjet përdorimit të sistemit DevInfo databaza e pasur dhe e konsoliduar me informacione statistikore është e aksesueshme online në faqen: <http://www.observator.org.al/odf-map/>.

Deri tani databaza e të dhënave të Observatorit ka qenë një burim unik i të dhënave të disagreguara: një ndërfaqe e lehtë në përdorim lejon përdoruesin të marrë informacion për 374 njësitë vendore, bashki dhe komuna të Shqipërisë.

Studimi “Martesat e Hershme në Shqipëri – Fokus mbi Komunitetin Romë” është realizuar duke u mbështetur në gjejtet dhe analizat e studimeve të më parshme, në aksionet dhe politikat e ndjekura nga Shteti Shqiptar, si dhe në analizat e dokumenteve

ndërkombëtare dhe legjislationit në vend, - adresuar çështjes për martesat e hershme në vend. Analiza e këtij studimi, bashkë me gjetjet e tij vjen në një moment të përshtatshëm, ndërsa po harton politikat dhe strategjitë kombëtare në mbrojtje të grupeve të caktuara apo të mbrojtjes sociale. Gjetjet e studimit, po shërbejnë si argumente lobuese për të patur më shumë vëmëndjen e politikbërësve dhe zbatimit të programeve në çështjen e martesave të hershme në Shqipëri.

Publikimet e Observatorit janë kontribues në debatin kombëtar mbi *çështjet e të drejtave të fëmijëve* dhe përfshijnë një gamë të gjerë të mendimeve. Për këtë arsye, Observatori mund të prodhojë botime që jo domosdoshmërisht pasqyrojnë politikën ose përfaqset e Ambasadës Kanadeze ndaj disa temave. Pikëpamjet e shprehura janë ato të autorëve dhe kontribuesve dhe janë publikuar nga Ambasada Kanadeze, me qëllim stimulimin e dialogut të mëtejshëm mbi të drejtat e fëmijës.

Kërkesa për leje për të riprodhuar ose përkthyer studimin e Observatorit duhet të adresohet në zyrën e Observatorit në info@observator.org.al ose stat@observator.org.al.

Për të shkarkuar këtë raport, ose për të hyrë në skedarin e publikimeve më të reja, ju lutemi shkoni në faqen e internetit të Observatorit në www.observator.org.al

Korrespondenca duhet t'i adresohet:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve

Bulevardi "Bajram Curri"

Pallatet Agimi

Shkalla 5, Ap.81

Tiranë, Shqipëri

Tel. 00355 4 22 58 987

E-mail: info@observator.org.al

Web www.observator.org.al

FALENDERIME

Ky raport u punua nga Znj. Mina Mata (Msc) dhe u asistua nga Znj. Klodjana Bregu. Znj. Mina Mata, me përkushtimin dhe kërkimin e gjerë kualitativ dhe kuantitativ, ka realizuar analizën e informacioneve dhe të dhënave nga shumë raporte dhe studime të ndryshme, si dhe përpunimin dhe interpretimin e informacioneve të grumbulluara nga fokus grupet. Kopja origjinale e këtij raporti u punua në gjuhën Angleze, duke u përkthyer më pas në gjuhën Shqipe.

Në sajë të punës së përkushtuar të koordinatorëve lokalë dhe stafit të Observatorit, u bë e mundur mbledhja e informacioneve në tre grupet komunitare të komunitetit Rom në Tiranë. Një proces konsultimi u ndërmorr përpara finalizimit të gjetjeve kryesore, rekomandimeve dhe publikimit të raportit me përfaqësues të MMSR, MAS, ASHMDF, UNFPA dhe agjenci të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky studim u realizua nën drejtimin dhe vëmendjen e Drejtoreshës Ekzekutive të Observatorit, Elma Tërshana, PhD (c).

Ju jemi mirënjohës gjithashtu dhe përfaqësuesve të Institucioneve të ndryshme, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësuesve të komunitetit Rom në vend për kontributin dhe bashkëpunimin institucional që i kanë ofruar ekspertëve të Observatorit për realizimin e këtij studimi.

Dhe së fundmi gjejmë rastin për të falënderuar Ambasadën Kanadeze, CFLInë Shqipëri, që mundësoi financiarisht studimin.

TABELA E GRAFIQEVE

- Grafiku 1:** Përqindja e martesave mbi 20 vjeç e sipër (2001 – 2013)
- Grafiku 2:** Përqindja e martesave sipas seksit dhe grupmohave për vitin 2013.
- Grafiku 3:** Moshë mesatare e martesës sipas gjinisë, 2000 - 2013
- Grafiku 4:** Madhësia mesatare e familjes në shoqërinë Shqiptare (2002-2012)
- Grafiku 5:** Statusi martesor i fëmijëve (15-18 vjeç) në të gjithë popullsinë – 2011
- Grafiku 6:** Statusi martesor i fëmijëve nga moshë (15-18 vjeç) për të gjithë popullsinë, sipas gjinisë – 2011
- Grafiku 7:** Përqindja e fëmijëve të martuar në total e ndarë sipas moshës dhe gjinisë – 2011
- Grafiku 8:** Përqindja e fëmijëve të divorcuar në total e ndarë sipas moshës dhe gjinisë – 2011
- Grafiku 9:** Përqindja e fëmijëve të ve në të gjithë popullatën e ndarë sipas moshës dhe gjinisë – 2011
- Grafiku 10:** Statusi i martesave tek fëmijët Rom 13-18 vjeç – 2011
- Grafiku 11:** Përqindja e fëmijëve Rom beqarë (13-18 vjeç) – 2011
- Grafiku 12:** Përqindja e fëmijëve Rom të martuar (13-18 vjeç) – 2011
- Grafiku 13:** Përqindja e fëmijëve Rom të cilët bashketojnë (13-18 vjeç) – 2011
- Grafiku 14:** Përqindja e fëmijëve Rom që përfaqësojnë në shoqërinë shqiptare- 2011

- Grafiku 15:** Statusi martesor i fëmijëve – Krahasim midis shoqërisë shqiptare dhe popullatës Rome, 2011
- Grafiku 16:** Përqindja që fëmijët Rom përfaqësojnë në të gjithë shoqërinë shqiptare fëmijët beqar - 2011
- Grafiku 17:** Përqindja që fëmijët e martuar Rom paraqesin, përfaqësojnë fëmijët e martuar në të gjithë shoqërinë shqiptare. – 2011
- Grafiku 18:** Moshë në të cilën të intervistuarit janë të martuar ose bashkëjetojnë-2015
- Grafiku 19:** Moshë në të cilën të intervistuarit janë të martuar/ bashkëjetojnë të ndarë sipas seksit - 2015
- Grafiku 20:** Numri i fëmijëve i të intervistuarit aktual - 2015

PËRMBAJTJA

Falenderime.....	5
Tabela e grafiqeve.....	6
Përmbajtja	8
Martesat e Hershme në Shqipëri – Fokusuar mbi Komunitetin Rom.....	11
Përshkrim i përgjithshëm mbi studimin.....	11
Gjetjet Kryesore:.....	14
Rekomandime dhe pengesa:.....	15
Çfarë janë martesat e hershme?.....	19
3. Konteksti Ligjor Kombëtar dhe Ndërkombëtar.....	24
3.1 Normat Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut që adresojnë Martesat e Hershme të ratifikuara nga Shteti Shqipëtar	25
4. Faktorët që kontribuojnë në Martesat e Hershme të fëmijëve dhe efektet që këto martesa sjellin.....	34
4.1 Faktorët kryesorë që cojnë në Martesa të Fëmijëve.....	35
4.1.1 Normat kulturore dhe Vlerat.....	35
4.1.2 Varfëria.....	35
4.1.3 Frika nga rrëmbimi dhe prostitucioni.....	36
4.1.4 Kontrolli i lindjeve.....	37
4.2 Efektet e martesave të Hershme.....	37
4.2.1 Nivel i ulët arsimor.....	37
4.2.2 Kujdesi i pakët për fëmijët.....	38
4.2.3 Rritja e përqindjes së divorceve.....	38
4.2.4 Arsimi dhe ekonomia:.....	39
4.2.5 Seksualiteti dhe dhuna.....	39
4.2.6 Rreziku i shëndetit.....	40
5. Analiza lidhur me fenomenin e martesave të hershme në Shqipëri-Një vështrim i veçantë për Komunitetin Rom.....	40

5.1 Dimensioi i parë- Një vështrim lidhur me martesat në shoqërinë shqiptare.....	41
5.2 Dimensioi i dytë -Martesate e hershme në Shoqërinë Shqiptare	45
5.3 Dimensioi i tretë -Martesate e hershme në komunitetin Rom.....	49
5.4 Dimensioi i katërt - Pjesa që komuniteti Rom zë në të gjithë popullatën përta i përket martesave të fëmijëve.....	52
6. Analiza e martesave të Hershme në Komunitetin Rom në Shkozë, në zonën e Liqenit dhe zona e Tufinës- Studim Rasti.....	56
Referenca.....	61
Aneks:	
Foto të ndryshme nga takimet e hapura dhe Fokus grupet në Komunitetin Rom në Shkozë, në zonën e Liqenit dhe zonën e Tufinës....	63

MARTESAT E HERSHME NË SHQIPËRI – FOKUSUAR MBI KOMUNITETIN ROM

Përshkrim i përgjithshëm mbi studimin

Martesa e fëmijëve është një praktikë që ka vazhduar për shekuj me radhë. Në ditët e sotme, është quajtur si një bashkim formal ose zakonor në të cilën një ose të dy palët janë nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Kjo praktikë ka ekzistuar nëpër rajone, kultura dhe fe, edhe pse prek fëmijët e të dy gjinive, vajzat janë të prekura në mënyrë disproporcionale.

Origjina e martesave të fëmijëve është multidimensionale dhe me rrënjë të thella. Historikisht, martesat e hershme janë përdorur si një mekanizëm për të rritur pjellorinë në kontekstin e normave të vdekshmërisë së lartë. Martesa e fëmijëve është përdorur në marrëdhëniet e mëtejshme ekonomike, politike apo sociale. Sot, kjo traditë e motivuar nga varfëria, marginalizimi social dhe normat kulturore dhe përjetësohet nga pabarazia gjinore dhe statusit të ulët të vajzave dhe grave.

Problemet ekonomike janë thelbësore për praktikën e martesës së fëmijëve. Në zonate pafavorizuar dhe ato rurale, ku tradita e martesës së fëmijëve është më e përhapur, edukimi i limituar

dhe gjendja jo e mirë ekonomike për vajzat rrisin mundësinë për martesat e hershme. Përveç kësaj mundësitë ekonomike që lidhen me martesat shpesh kanë një vlerë tek të rinjtë, të cilët shtojnë familjet e varfëra në martesat e vajzave të tyre, në mënyrë që të rritet stabiliteti ekonomik. Praktika të tilla si cmimi për nusen ose pasuria e nuses, ku familja e dhëndërit jep paratë ose pasuritë e nuses, gjithashtu inkurajojnë martesat e hershme për faktin se nuset e reja kanë vlera më të mëdha sepse ato kontribuojnë më shumë me kalimin e kohës për dhëndrin dhe familjen e tij¹.

Martesa e hershme është një fenomen që prek si vajzat ashtu edhe djemtë në të njëjtën kohë, por në mënyra të ndryshme, duke e kthyer atë në një fenomen gjinor. Përgjithësisht ky fenomen është më i dukshëm tek vajzat se sa tek djemtë, duke e bërë normën më të madhe të martesave të hershme më të ulët tek djemtë sesa tek vajzat. Ky fenomen është i lidhur me faktorë të ndryshëm që shkaktojnë këtë problem, por në të njëjtën kohë ky fenomen ka pasojat e ndryshme socio-ekonomike. Vajzat e martuara janë gjithashtu pre e dhunës familjare dhe abuzohen seksualisht brenda marrëdhënies e janë jo të barabarta, dhe në qoftë se ato ngelen shtatzanë, shpesh ato hasin ndërlikime gjatë shtatzanisë dhe lindjes, për shkak se fiziku dhe zhvillimi biologjik i tyre nuk është gati që të lindin fëmijë. Pas martesës, të dyja palët si vajzat ashtu edhe djemtë shpesh duhet që të lënë shkollën për tu futur në punë/ ose marrin përsipër përgjegjësinë e shtëpisë.

Martesat e hershme nuk janë hulumtuar mirë, apo janë adresuar në mënyrë periferike si një nën-produkt i çështjeve të tjera, të tilla si: përjashtimi etnik me bazë sociale, diskriminimi dhe varfëria. Një përmbledhje e disa studimeve tregon se martesat e hershme në Shqipëri janë më të praktikuara midis grupeve etnike të Romëve. Këto martesat e hershme gjithashtu ndodhin në disa komunitete Sh-

1 *European Roma and Travellers Forum & Romani Women Informal Platform "Phenjalipe" (2014), Making Early Marriage in Roma Communities a Global Concern, faqe 7*

qipëtare që jetojnë në zona ekstremisht të izoluar apo në zona të varfra rurale. Martesat e të miturve, kryesisht nuk regjistrohen në gjendje civile, kështu qëpavarësisht se ato ndodhin në jetën e përditshme, të dhënat zyrtare për ta nuk janë të plota. Kjo tregon se të dhënat e sakta statistikore për këtë rast në Shqipëri të pakta.

Ky studim i realizuar nga “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve” trajton çështjen e martesave të hershme, me fokus Komunitetin Rom. Gjatë realizimit të këtij Studimi, u hasën shumë vështirësi dhe shumë kufizime, si: mungesa e ekspertëve për këtë fushë në Shqipëri, mungesa e të dhënave të përditësuara të procesit të shqyrtimit, si dhe mungesa e kulturës për të bashkë-biseduar rreth këtij fenomeni me komunitetin Rom (me shtrirje në zonat pilot të këtij studimi).

Studimi është ndarë në tre pjesë. Pjesa e parë dhe e dytë është bazuar në shqyrtimin e gjithë dokumenteve, studimeve apo raporteve të realizuara më parë nga Institucione apo aktorë të ndryshëm (desk reviw); ndërsa pjesa e tretë është bazuar në vëzhgimet në terren që Observatori për të Drejtat e Fëmijëve ka bërë në 3 zona pilot ku jeton Komuniteti Rom. *Pjesa e parë* mbulon anën teorike duke analizuar këtë fenomen që nga kuptimi i saj që ka popullata Shqiptare dhe Komuniteti Rom, duke analizuar gjithashtu kontekstin Ligjor Kombëtar dhe Ndërkombëtar të cilat ndalojnë martesat e hershme të fëmijëve dhe duke e mbyllur me faktorët të cilët kontribuojnë tek martesat e hershme dhe efektet që sjellin këto martesat. *Pjesa e dytë* është një përmbledhje e të dhënave nga Regjistrimi i popullsisë Shqiptare 2011 dhe Harta Rome 2011 dhe ku fenomeni i martesave të hershme është parë nga ana statistikore. Në këtë pjesë është bërë një krahasim i detajuar i martesave të hershme midis popullsisë Shqiptare dhe asaj Rome. *Pjesa e tretë* dhe e fundit është fokusuar në vëzhgimet në terren që Observatori ka bërë në tre zona pilot (Shkozë, Tufinë dhe zona e Liqenit). Nga vëzhgimet në terren, përveç takimeve me komunitetin, është përdorur dhe një pyetësor për një qasje më të mirë të të dhënave.

Gjetjet Kryesore:

Studimi rreth martesave të hershme në Shoqërinë Shqiptare me një fokus të veçantë për Komunitetin Rom njih të dhënat si më poshtë:

- Shumica e fëmijëve Shqiptarë janë beqar dhe përbëjnë 96.9% ose 6179 të fëmijëve. Pjesa e fëmijëve nga mosha 15-18 vjeç që janë të martuar është 2.92% ose 186 fëmijëve, e cila zë një vlerë të konsiderueshme. Tre (3) kategoritë e tjera të fëmijëve kanë status si të martuar ose janë fëmijë të divorcuar që përbëjnë 0.05% ose 3 fëmijë të moshës 15-18 vjeç, fëmijë të ve janë 0.14% ose 9 fëmijë të moshës 15-18 dhe jo ligjërisht të ndarë që përbëjnë 0% të fëmijëve;
- Përqindja e fëmijëve Rom beqar nga mosha 13-18 vjeç është 76% ose 1488 fëmijë. Rrjedhimisht përqindja e kategorive të tjera (të martuar, të divorcuar, të rinj që bashketojnë) është më e lartë për këtë Komunitet. Përqindja e fëmijëve të martuar në Komunitetin Rom është 9% ose 180 fëmijë. Pjesa më e madhe e fëmijëve të cilët jetojnë në komunitetin Rom përfshijnë 14% ose 275 fëmijë, ndërkohë vetëm 1% e fëmijëve Rom janë të ndarë por ligjërisht të martuar;
- 21.4% e fëmijëve të moshës 15-18 vjeç e fëmijëve të shoqërisë Shqiptare janë fëmijë Rom. Në krahasim me fëmijët e martuar dhe beqar Rom të shoqërisë shqiptare, mund të themi se: 14.7% e fëmijëve beqar të shoqërisë shqiptare janë fëmijë Rom dhe 93.5% e fëmijëve të martuar në shoqërinë Shqiptare janë fëmijë Rom;
- Nga intervistat e realizuara në tre zonat pilote, shumica e të intervistuarve ishin më të mëdhenj se 18 vjeç, dhe kishin qënë të martuar/ose bashkjetues që në moshë të re. Nga të 60 të intervistuarit, 59 nga ata deklaruan se ishin të martuar para moshës 18 vjeç dhe nga këta 36 nga ata deklaruan se nuk ishin të martuar ligjërisht dhe të celebruar;
- Shumë nga të intervistuarit vajza ishin martuar që në moshën

13 vjeçare (9) femra, dhe në moshën 17 vjeçare (8 femra), dhe shumica e djemve ishin martuar në moshën 17 vjeçare (7 meshkuj);

- Persa i përket të intervistuarve, kishin patur fëmijën e tyre të parë kur kishin qënë më pak se 18 vjeç, mund të themi 47% prej tyre (28 individë). Të pyetur rreth njohurive për planifikimin familjar 51% (31 prej tyre) u përgjigjën se ata nuk kishin informacion përreth mënyrave të Planifikimit Familjar, 12% (përreth 7 individë) u përgjigjën se kishin informacion rreth Planifikimit Familjar dhe e praktikonin atë dhe 37% (përreth 22 prej tyre) u përgjigjën se kishin informacion por nuk e praktikonin atë.

Rekomandime dhe pengesa:

- Sipas Kodit të Familjes, neni 7, parashikon martesën midis burrit dhe gruas të cilët kanë arritur moshën madhore 18 vjeç. Megjithatë Kodi Penal nuk e ka kriminalizuar martesën e fëmijëve. Ka një referencë të Kodit Penal, neni 130, i cili tregon se fillimi i një bashkjetese të detyruar ose vazhdimi i një bashkjetese si dhe kërkesa e një të rrituri për të dalë jashtë territorit të shtetit Shqiptar me një fëmijë duke e detyruar atë të martohet, dënohet me gjobë ose me tre muaj burgim. Sipas neni 100 po të Kodit Penal, marrëdhënia seksuale me një të mitur nën moshën 14 vjeçështë një vepër penale, e cila ka një dënim nga 7 deri në 15 vjet burgim, ndërkohë që marrëdhënia seksuale me një të mitur nën moshën 14-18 vjeç dënohet nga 5 deri në 15 vjet burgim. Nga i gjithë ky vëzhgim juridik mund të konstatojmë se ka një nevojë në Legjislacionin Shqiptar për të evidentuar në mënyrë specifike se martesat e hershme janë të dënueshme;
- Në kuadër të studimit dhe në ndjekje të zbatimit të rekomandimeve të Gjenezës dhënë Shqipërisë në lidhje me zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) (në Tetor të vi-

tit 2012), Observatori ka kontaktuar shumë institucione shtetërore dhe jo shtetërore për ti pyetur ato rreth hapave konkrete që janë marrë nga Qeveria Shqiptare ose nga Shoqëria Civile për të përmirësuar situatën e fëmijëve në Shqipëri rreth çështjes së martesave të hershme. Disa nga përfaqësuesit e partnerëve (qeveria dhe shoqëria civile) të Observatorit nuk kanë informacion të përditësuar rreth problematikës për martesat e hershme të fëmijëve, përveç disa studimeve sporadike që disa organizata partnere (OJF) kanë ndërmarrë në disa zona të Shqipërisë. Bazuar në gjetjet e studimit, Shqipëria duhet të ndërmarrë masa për të përmirësuar dhe lehtësuar fenomenin e martesave të hershme;

- Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve Shqiptare ka nevojë të reflektojë fenomenin e martesave të hershme. Ka akoma një mungesë të sistemit të referimit për identifikimin e rasteve të fëmijëve të martuar, kështu që institucionet duhet të punojnë akoma për të ndërtuar një sistem referimi për martesat e hershme;
- Nevoja për të intesifikuar bashkpunimin me policinë, si një partner kryesor në koordinimin e sistemit dhe realizimin e detyrimeve ligjore për të gjitha hapat që mund të ndërrmerren në sistemin e referimit;
- Fenomeni i martesave të hershme duhet të ketë vëmendje të vecantë nga aktorë të ndryshëm institucional dhe jo institucional në mënyrë që të zvogëlohet ky fenomen dhe efektet e tij;
- Nevoja për të reflektuar efektet negative të martesave të hershme në lëndë të ndryshme shkollore, dhe aktivitete dhe për të intesifikuar përpjekjet për përfshirjen e fëmijëve Rom për të vazhduar shkollën;
- Nevoja për të përmirësuar politikat sociale në mbrojtje të grupeve në nevojë, sic është praktikuar me skemën e ndihmës ekonomike duke i motivuar më para kesh prindërit që mund të dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë. Një strategji e tillë duhet të përdoret në mënyrë që të reduktohet ky fenomen;

- Shkalla e lartë e vdekjeve është parë si një faktor që çon në praktikën e fenomenit të martesave të hershme midis komunitetit Rom;
- Nevoja për të reflektuar fenomenin e martesave të hershme në Planin e veprimit Kombëtar të Integritit të Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri 2015-2020.
- Nevoja për të rritur dhe rialokimin e fondeve për fushata ndërgjegjësimi për problemet shëndetësore dhe risqet e shëndetit që martesat e hershme mund të sjellin. Për momentin fondet e vëna në dispozicion për promovimin e shëndetit është 54.000 ALL dhe nuk është e mjaftueshme për të adresuar këtë problem;
- Nevoja për të adresuar këtë fenomen të martesave të hershme në Standartet e Protokollit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve të Agjensive Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, e cila është firmosur nga 4 (katër) Ministri; Ministria e Mirëqënies sociale dhe Rinisë (MPCS), Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), Ministria e Shëndetësisë (MSH) dhe Ministria e Integritit Evropian (MIE);
- Duke përllogaritur përqindjen që fëmijët e Komunitetit Rom zënë në shoqërinë Shqiptare në statuse të ndryshme martesore, mund të shohim se në shumë kategori vlerat janë shumë të larta dhe kalojnë 100% ose mund të shohim gabime në raportim. Kjo mund të rezultojë kur individët e komunitetit Rom kanë tendencë të deklarojnë veten e tyre si të martuar ose të divorcuar kur ata nuk janë ligjërisht të martuar por vetëm bashketojnë, ose mund të jetë një gabim i vazhdueshëm në intervistimin e familjeve;
- Gjatë procesit të kërkimeve në fushë dhe gjatë intervistave të bëra, shumë nga individët e komunitetit Rom refuzuan të marrin pjesë në procesin e intervistave, kështu që ka akoma nevojë për fushata ndërgjegjësimi në këtë drejtim;
- Nga procesi i kërkimit në terren, dalim në përfundimin se komuniteti Rom ka nevojë për fushata ndërgjegjësimi rreth këtij

fenomeni të martesave të hershme dhe impakti që ky fenomen ka në shoqëri dhe zhvillimin e saj;

- Një element tjetër që ka nevojë për fushata ndërgjegjësimi është rreth informacionit për planifikimin familjar që familjet Rome kanë një mungesë të madhe, kjo për shkak se gjatë intervistave shumë nga ata u përgjigjën që nuk kishin informacion rreth mënyrës së Planifikimit Familjar.

ÇFARË JANË MARTESAT E HERSHME?

Martesa e hershme, e përkufizuar si martesë formale ose si një bashkim informal që kryhet para moshë 18 vjeç, është një realitet si për vajzat ashtu edhe djemtë, megjithëse vajzat janë në mënyrë disproporcionale më të prekura. Martesa e hershme është përhapur dhe mund të çojë në një jetë me dizavantazh dhe privim².

Sipas UNICEF (2014), më shumë se 700.000 milion gra në të gjithë botën janë martuar në moshë të hershme. Më shumë se 1/3 ose diku tek 250 milion – janë martuar para moshës 15 vjeç. Vajza të cilat martohen para se të mbushin 18 vjeç, kanë më pak gjasa që të vazhdojnë shkollën dhe janë më të dispozuara që të përjetojnë dhunë në familje. Vajzat e reja adoleshente kanë më shumë gjasa të vdesin gjatë shtatzanisë për shkak të komplikacioneve gjatë shtatzanisë dhe lindjes se sa gratë në moshën 20 vjeç; të vegjlit e tyre kanë shumë gjasa të dështojnë ose të vdesin në muajt e parë të jetës.

Martesa e hershme ka dy forma të ndryshme të manifestimit që praktikuar në disa komunitete. *E para* është martesë e një vajze të vogël me një mashkull adult (të rritur), martesë e paramenduar dhe e detyrë, pa përmbushur moshën ligjore për martesë. *Praktika e dytë* është një formë martesë e menduar në të cilën prindërit e dy fëmijëve nga familje të ndryshme organizojnë një martesë të ardhshme. Në këtë mënyrë të dy fëmijët bëhen “të fejuar” derisa ata konsiderohen se kanë arritur moshën e martesës. Vlerësimi i kësaj moshe varet shumë nga kultura e grupit, por në shumicën e

2 UNICEF (2014), *Mbrojtja e Fëmijëve nga dhuna, përdhunimi dhe abuzimi – Martesat e hershme*

rasteve është në kohën ose para fillimit të pubertetit. Fejesa është një akt ndryshe nga martesat, ku virgjëria e vajzës është një nga elementët kryesor të marrëveshjes³.

1. Martesat e hershme në Shoqërinë Shqiptare

Sipas UNFPA(2012), martesat e hershme në Shqipëri është praktikuar në dy dekadat e fundit në shoqërinë Shqiptare vecanërisht në zonat e thella rurale, në zonat malore, ku mentaliteti patriarcal bashkohet me varfërinë. Kjo zakonisht ka qënë e lidhur me vajzat poshtë moshës 18 vjeç, ndërkohë që djemtë martohen më të mëdhenj në moshë, zakonisht 20 deri në 30 vjeç. Megjithatë ky fenomen është zbehur në vitet e fundit, ai prapë ekziston.

Zakonisht martesat janë organizuar nga familjet dhe vajzat nuk kanë mundësi të zgjedhin bashkshortin ose mundësinë për ta refuzuar atë. Dominimi mashkull luan një rol të rëndësishëm. Babai është ai që bën zgjedhjen dhe merr vendimin për vajzën, kurse nënat nuk kanë të drejtë të ndërhyjnë në negociata për fatin e vajzave të tyre.

Vajzat që jetojnë në këto fshatra të thellta nuk mund të bëjnë zgjedhjet e tyre, për faktin se shumica e tyre nuk kanë udhëtuar asnjëherë jashtë fshatit të tyre. Shumë prej vajzave që jetojnë në këto komunitete lënë shkollën në moshën 12-13 vjeç, më mënyrë që të angazhohen me punët shtëpiake dhe të përgatiten për martesë. Vajzat mbahen larg jetës sociale dhe shkollës, kështu që martesat duket të jetë zgjedhja më e mirë për to. Martesat e hershme në zonat e thella rurale ndjekin një model të veçantë. Vajzat janë të fejuara që në moshën 13-15 vjeç. Dasma bëhet disa vjet më vonë, dhe pas kësaj vajzat shkojnë të jetojnë tek shtëpia e burrit të tyre. Dhëndërit zakonisht janë emigrant në vende të tjera dhe kthehen në shtëpi njëherë ose dy herë në vit, kështu që ata lënë gratë e tyre

3 *Bitu. N dhe Morteau.C (2010), Janë të Drejtat e Fëmijëve të Negociueshme? Problematikat e martesave të hershme Brenda Komunitetit Romnë Rumani, Bukuresht, ISBN 978-973-139-143-4, faqe. 29*

të jetojnë bashkë me familjet e tyre dhe shkojnë në emigrim.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve cdo vit monitoron të drejtat e Fëmijëve në nivel rajonal dhe një nga temat e identifikuar gjatë vizave të monitorimit është fejesa e hershme e vajzave (duke mos arritur moshën 18 vjec) me aprovimin e prindërve të tyre. Një rast I identifikuar në qytetin e Lacit (Kurbin), ku 90% e vajzave në shkollë të mesme (poshtë 18 vjec) janë të fejuara, dhe të premturara për martesë.

Observatori për të Drejtat e fëmijëve në Lezhë- Korrik 2013

Zakonisht braktisja e shkollës ndodh para përfundimit të arsimit të detyruar (për pjesën më të madhe të grupit), dhe para përfundimit të shkollë fillore (për Romët), kjo gjë është si parashikues për martesën. Braktisja e shkollës mund të ndodhë para ose pas martesës, dhe është një vendim I marrë nga prindërit, i rrënjosur në besimin e tyre se “shkolla nuk është e ardhmja”. Prindërit nuk e shohim një të ardhme për vajzat e tyre përtej të qenit një bashkëshorte, zonjë shtëpie, dhe nënë. Braktisja e shkollës është raportuar për të dy gjinitë në vitet e fundit të arsimit të detyrueshëm, por për arsye të ndryshme. Djemtë priren të lënë shkollën në mënyrë që të hyjnë në tregun e punës, ndërsa vajzat e braktisin në mënyrë që të përgatiten për martesë.

Në dekadat e fundit, këto martesakanëqenë pjesë e fenomenit të trafikimit. Mundësia për të patur një dhëndër të pasur është aq tërheqëse për familjet nuse të ardhshme është igatshëm për të dhënë pëlqimin për martesë edhe nëse ata edinë shumë pak për të ardhmë dhëndërrit, i cili në fakt mund jetë një trafikant⁴.

2. Martesat e hershme në Komunitetin Rom

Martesat e hershme ndodhin për shkak të të njëjtëve faktorë

4 *Fondi i Popullsisë së Kombeve të Bashkuara në Shqipëri - UNFPA (2012), Martesat e Hershme në Shqipëri (përmbledhje), Versioni 1*

ekonomik dhe faktorë të marginalizimit edhe në komunitetin Rom. Dhe ky komunitet nuk mund të ndahet nga kjo praktikë e martesave të hershme. Bazuar në studimin e Romëve European dhe Forumit të Udhëtarëve & Platformës Informale të Grave Rome “Phenjalipe” (2014), kur flitet për martesate hershme në komunitetin Rom ka shumë mospërputhje. Duke konsideruar martesat e hershme, në komunitetin Rom dhe jo vetëm, në një perspektivë të drejtave të njeriut ajo mund të denoncohet si një praktikë e dëmshme kulturore, e cila është kundër normave evropiane. Ndërsa martesat e hershme dënohet si njëshkelje e të drejtave të njeriut, ka një mungesë në përgjigjet të cilat adresojnë sukseshëm problemin nga ana e aktoreve shtetërore, komuniteteve të përfshira, dhe familjeve të ndikuara.

Në kohën e skllavërisë në Rumani, si një zgjidhje kundër abuzimeve seksuale të mundshme nga pronarët e skllavëve, Romet i martonin bijat e tyre ndërsa ato ishin ende shumë të reja, ndërkohë, pasi martoheshin, vajzat nuk do të paraqisnin të njëjtin lloj të interesi për pronarët. Në të njëjtën kohë, emigruan nga India, ku martesat e fëmijëve ishin themeluar ndër shekuj, dhe martesat e hershme ishin një praktikë që mund të ketë qenë edhe përjetësohet si rezultat i trashëgimisë indiane. Martesat e Hershme në Komunitetin Rom, një shqetësim

Global – Romët European dhe Forumi i Udhëtarëve & Platforma Informale e Grave në Rumani” “Phenjalipe”

Përgjithësisht martesat e hershme në komunitetin Rom kanë bërë që kultura e këtij komuniteti të gjykohet nga ky fenomen. Kur tiparet e kulturës së komunitetit Rom janë përshkruar në një mënyrë negative në një shoqëri, traditat e veçanta dallohen dhe janë identifikuar si karakteristikat më të këqija të këtij komuniteti.

Në këtë mënyrë, martesat e hershme në këto shoqëri përgjithësisht identifikohen dhe adresohen me komunitetin Rom. Ky fenomen është identifikuar si dhunim i të Drejtave të Njeriutku sh-

teti përgjigjet sipas standarteve dhe instrumenteve Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut. Kjo nuk funksionon gjithmonë sepse në shumicën e rasteve identifikohet si traditë e vecantë e komunitetit Rom, gjë e cila trajtohet brenda komunitetit Rom.

Në ditët e sotme ky fenomen është zvogëluar krahasuar me 10-20 vjet më parë. Vazhdon të jetë i dukshëm në vende të margjinalizuara dhe komunitetet e varfra tradicionale. Shumëfaktorë ekonomiko-socialcojnë në martesë të hershme si psh: rinia, dashuria dhe dëshira për të formuar një familje të bashkuar, presioni i familjes, pasiguria financiare e një familjeje, varfëria e madhe, mungesa e prepsektivave, braktisja e shkollës, mungesa e unifikimit familjar/adoptimi, marrëdhëniet seksuale jashtë martesë, shtatzani e pa planifikuar, përdhunime, presioni i kolegëve, praktika e komunitare, etj.

Për vite me rradhë faktori kryesor që ka cuar në martesat në moshë të vogël ka qënë varfëria, i cili në pak vite është përkeqësuar nga kriza ekonomike. Kur vajzat e reja arrijnë një moshë të caktuar, shihen si barrë ekonomike në familje dhe martesë e tyre me burra në moshë më të madhe shikohet si një strategji për të mbijetuar varfërisë.

Mungesa e punësimit në komunitetin Rom ka një impact të madh në braktisjen e shkollës dhe traditën e martesës. Edhe pse kultura e tyre shihet si indiferente ndaj arsimit dhe përfitimeve që do mund të kishin femijet e tyre prej arsimit, e verteta është që komuniteti rom diskriminohet pergjithesisht ne tregun e punes, kane shanse me te vogla punesimi, punesim te pakte dhe paga me te uleta per shkak te arsimit te tyre. Meqënëse ata kanë më pak të ardhura për shkak të arsimit, është e logjikshme për ta që të gjejnë mënyra të tjera jetese dhe fitimi. Ne zakonisht marrim vendime per arsimimin tonë duke ditur vlerën që ka arsimit, si në aspektin e kostos dhe përfitimeve të saj tani, dhe duke ditur përfitimet dhe të mirat që sjell ai në të ardhmen. Në këtë mënyrë Romët e njohin arsimimin si një gjë të dobishme, të paktën për nga ana ekonomike. Ndërkohë, paralelisht, mungesa e punësimit tek vajzat Rome con drejt martesës në moshë mjaft të re. Në të njëjtën kohë niveli i arsimit tek prindërit Rom ndikon drejtpërdrejt në vendimet e tyre

për martesat në moshë të re te vajzave të tyre.

Roli i shtetit është gjithashtu jo shumë përkrahës kur është fjala për mbrojtje ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare kur gratë dhe vajzat Rome janë subject i martesave të hershme. Këto lloj martesash nuk janë gjithashtu të regjistruara në zyrën e regjistrimit Civil, ose janë të regjistruara me urdhër të Gjykatës tribunale. Mungesa e vullnetit për të ndërhyrë me forcë, për të penguar dhe sanksionuar këto martesat “duke bërë një sy qorr” ose duke u mbështetur tek një thënie “kjo është një traditë e Romëve, dhe çështje e brendëshme⁵.

3. Konteksti Ligjor Kombëtar dhe Ndërkombëtar

Martesat e hershme shkelin të drejtat e fëmijëve për të qënë të lirë nga të gjitha format e diskriminimit, trajtim cnjerëzor dhe jo human dhe skllavëror. Ajo shkel një sërë të drejtash, përfshirë, të drejtën për barazi, bazuar tek seksi dhe moshja, të drejtën për tu martuar dhe krijuar një familje, të drejtën për të jetuar, të drejtën për të patur një standart tëmundshëm të mirëqënies, të drejtën për edukim dhe zhvillim. Duke iu referuar martesave të hershme si shkelje e të drejtave të njeriut gjithashtu ndihmon për ta ngritur atë si një shqetësim publik më shumë se sa ta trajtosh atë si një problem brenda familjes.

Është shumë e rëndësishme për një vend që të përfshijë në dokumentat legjislativë minimumin e bazës ligjore për martesat. Ligjet që përcaktojnë një minimum të moshës për martesë janë mjaft të rëndësishëm për të mbrojtur djemtë dhe vajzat nga të qënë të martuar para se ata të jenë gati. Është e rëndësishme që fëmijët të njihen nga ligji si të qënë fëmijë dhe që ata mbrohen nga një marrëveshje e plotë ligji. Qeveritë kanë nevojë të kenë një legjislacion të qartë dhe të qëndrueshëm që përcakton moshën 18 vjeç si moshën minimale për martesë. Masa mbrojtëse të përshtatëshme

5 *European Roma and Travellers Forum & Romani Women Informal Platform “Phenjalipe” (2014), Making Early Marriage in Roma Communities a Global Concern, fq. 9*

duhet të jenë të vendosura për të siguruar që pëlqimi i prindërve ose mënyra të tjera të mos përdoren për të martuar vajzat pa pëlqimin e tyre. Ekzistenca e ligjeve që vendosin minimumin e moshës për martesë është një mjet i rëndësishëm që ndihmon ata që punojnë kundër këtyre martesave në moshë të re.

Kjo pjesë analizon komiza të ndryshme ligjore dhe dimensionet e drejtave të njeriut për martesat e hershme. Duke shqyrtuar peisazhin e ligjeve që kanë impakt tek gratë dhe vajzat, ne jemi në gjendje të vijmë me një gamë të gjerë alternativash dhe me kuptim më të sofistikuar se si fillesa të shumta të ligjit dhe strategji ligjore innovative mund të konvergojnë për të parandaluar martesat e hershme.

3.1 Normat Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut që adresojnë Martesat e Hershme të ratifikuara nga Shteti Shqipëtar⁶

Traktatete ndryshme ndërkombëtare, konventat, dhe programet e arritura adresojnë tek martesat e fëmijëve. Këto instrumente ndërkombëtare mbulojnë shfuqizimin e zakoneve të dëmshme dhe traditave, dhunën ndaj fëmijës vajzë, pëlqimin e martesës, moshën e martesës, regjistrimin e martesës, dhe lirisë për të zgjedhur një bashkëshort. Më konkretisht aktet ndërkombëtare në të cilat ndalojnë martesën e fëmijëve dhe janë të ratifikuara nga qeveria shqiptare janë si më poshtë:

3.1.1 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ)

E drejta përpëlqimin plotësisht të lirë në një martesë është njohur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Njohja se pëlqimi nuk mund të jetë i lirë dhe i plotë, kur njëra nga palët të përfshira nuk është mjafti pjekur për të bërë një vendim të informuar në lidhje me një partner të jetës, është një shkelje e DUNDJ. Neni 16

6 *De Silva-de-Alwis, Rangita (2008), Martesat e hershme dhe Ligji –Iniciativat për Reformat Legjislative, Seri Letrash, New York, faqe. 4*

i DUDNJ referohet lirisë dhe pëlqimit të plotë për martesë.

3.1.2 Konventa e të Drejtave të Fëmijëve

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijësi referohet të drejtave të fëmijëvetë cilët kanë të drejtat e tyre.

Fëmija është marrësi i privilegjeve të drejtave të njeriut-sipaskësaj Konventedhe duke iu referuar (drejtpërdrejt os etërthorazi) me martesëne hershmee fëmijëve nënenet 1, 2, 3.6, 12, 19, 24, 28, 29, 34, 35 dhe 36.

TË DREJTAT E NDALUARA NGA MARTESATE E FËMIJËVE OSE MARTESAT E HERSHME NË CRC

Martesa e hershmedëmtonnjë numër tëtë drejtave të garantuaranga Konventambi të Drejtate Fëmijës::

- *E Drejta e edukimit (Neni 28).*
- *E drejta për t'u mbrojtur ngatë gjitha format edhunësfizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, përfshirë abuzimin seksual(neni19) dhe nga të gjitha formate shfrytëzimit seksual(neni34).*
- *E drejtapër të gëzuarstandardin më të lartëtë arritshëm të shëndetit(neni24)*
- *E drejta e informimitarsimor dhe profesionaldhe udhëzim(neni28)*
- *E drejtapër tëkërkuar, marrëdhedhënë informacion dhe ide(neni13).*
- *Edrejtë për pushim dhekohë të lirë, dhetë marrë pjesëlishtnëjetën kulturore(neni31).*
- *E drejtapër të mos undarë ngaprinçerit e tyrekundërvullnetit të tyre(Neni9).*
- *E drejta për mbrojtje kundër të gjitha format e shfrytëzimit që ndikojnë në çdo aspekt të mirëqenies së fëmijës (neni 36).*

3.1.3 Konventa për Eleminimin e çdo lloj Forme Kundër Diskriminimit të Grave (CEDAW)

E konsideruar si fatura e të Drejtave të Grave, CEDAW garanton përgjegjësinë e shtetit për të

siguruar këto të drejta. Shpallja e CEDAW ishte pika kulmore e përpjekjeve të lëvizjes së grave globale të të drejtave të njeriut për të sjellë së bashku në një dokument të vetëm një kartë të të drejtave të grave. Ai jep zë me nocionin se të drejtat e grave janë të drejta të njeriut. Kjo Konventë parashikon se fejesa dhe martesë e një fëmije do të kenë të gjitha veprimet e nevojshme, duke përfshirë legjislacionin, për të specifikuar një moshë minimale për martesë dhe për të bërë regjistrimin e martesave në një regjistër zyrtar. Dispozita e CEDAW në lidhje me martesën e fëmijëve është Neni 16 (1) dhe (2) i cili parashikon se burrat dhe gratë kanë të njëjtën të drejtë për të hyrë në martesë, kanë të njëjtën të drejtë për të zgjedhur lirisht bashkëshortin dhe të martohen vetëm me vullnetin e tyre të lirë dhe pëlqim të plotë, si dhe Fejesa dhe martesë e një fëmije nuk do të kenë asnjë efekt ligjor, dhe të gjitha veprimet e nevojshme, duke përfshirë legjislacionin, do të merren për të specifikuar një moshë minimale për martesë.

3.1.4 Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR)

Konventa Politike e Komitetit të të Drejtave të Njeriut ka zhvilluar interpretime të neneve të saj thelbësore duke lëshuar komente të përgjithshme. Detyrimet për palët shtetërore të zhvilluara në bazë të kësaj Konvente kërkon jo vetëm që shtetet të marrin masa për të mbrojtur gratë, të tilla si miratimin e ligjeve, por edhe për të marrë masat e aksionit afirmativ i projektuar për të siguruar gëzimin pozitiv të drejtave. Ajo gjithashtu imponon mbi shtetet që të kenë si detyrë për të marrë informacion në lidhje me rolin e grave në juridiksionin e saj, në mënyrë që të përcaktohet në mënyrë

specifike se çfarë masash shtesë duhet të merren. Neni 23 i ICCPR vendos për të drejtat e burrave dhe grave, moshën për martesë. Ajo gjithashtu thekson se asnjë martesë nuk duhet të lidhet pa pëlqimin e plotë dhe të lirë të bashkëshortit të synuar.

3.1.5 Konventa Ndërkombëtare Social ekonomike dhe të Drejtat Kulturore (ICESCR)

ICESCR parashikon në nenin 10 se martesat duhet të lidhet me pëlqimin e lirë të bashkëshortit të synuar. ICESCR në komentet përmbyllëse ka shprehur çështje për adresim/shqetësime për martesën e fëmijëve. Disa nga këto çështje mund ti shohim në vijim: Dallimet në moshën e martesës në mes të meshkujve dhe femrave është shkëlqje e Neni 10; praktika e martesës së hershme ka një ndikim negativ në të drejtën e shëndetësisë, arsimit dhe punës; Komiteti ICE ka rekomanduar gjithashtu se mosha minimale ligjore e martesës të jetë minimumi në moshën 18 vjeç.

3.1.6 Konventa Suplementare për Zhdukjen e Skllavërisë, Tregtisë Sllave Institucioneve dhe Praktikave

Konventa Plotësuese barazon çdo martesë që është kryer me forcë nga një vajzë apo grua nga familja ose kujdestarë të saj si të ngjashme me skllavërinë dhe kërkon që shteti ta eliminojë atë. Në nenin 1 (c), Konventa pengon martesën e fëmijëve.

3.1.7 Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës nr.182 për Eliminimin e Formave më të Këqija të Punës së Fëmijëve.

Sipas nenit 3 të “Konventës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës-së për Eliminimin e Formave më të Rënda të Punës së Fëmijëve”, të gjitha format e skllavërisë ose praktikave të ngjashme me skllavërinë, të tilla si shitja dhe trafikimi i fëmijëve, të detyruar ose punës së detyruar janë forma të cilat janë të ngjarë të rrezikojë shëndetin, sigurinë ose moralin e fëmijëve. Martesa e fëmijëve si

një formë e të drejtave dhe lirisë shkeljes dhe si një formë e skllavërisë pengon zhvillimin e fëmijëve.

3.1.8 Kushtetuta e Organizatës Botërore të Shëndetësisë

Kushtetuta OBSH shpreh të drejtën për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit dhe definon shëndetin gjerësisht si një gjendje e plotë fizike, mendore dhe mirëqenien sociale dhe jo thjesht si mungesa e sëmundjes ose dobësisë. Martesa e fëmijëve shkon ndesh me frymën e Kushtetutës OBSH.

3.1.9 Konventa kundërtorturës dhe mizorive të tjera, Ç’njëzore ose Poshtëruese apo Ndëshkimit (CAT)

Sipas nenit 1 të CAT, marrëveshja për zbatimin e ligjit në dështimin për të ndjekur penalisht përdhunimin në martesë të fëmijëve, veçanërisht në vendet ku akti i përdhunimit përfshin si përdhunimin martesor dhe atë jo-martesor.

3.1.10 Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) nuk përmban një të drejtë të qartë të shëndetit ose të drejtën për një mjedis të pastër. Megjithatë kjo Konventë është e lidhur me martesën e fëmijëve, si një e drejtë për jetën, neni 2 i KEDNJ dhe e drejta për respektimin e jetës private dhe familjes, neni 8 të KEDNJ-së, janë mbajtur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut për të imponuar dhe caktuar detyrimet pozitive për shtetin.

3.2 Normat kombëtareshqiptaretë Drejtave të Njeriut dhe Legjislacionit që trajton Martesat e Fëmijëve⁷

Sipas legjislacionit shqiptar dhe në Ligjin më të ri për Fëmi-

7 *Fondi i Popullsisë së Kombeve të Bashkuara në Shqipëri (2012), Martesat e Hershme në Shqipëri (Përmbledhje), Versioni i 1.*

jët, ligji 2010 mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, në përputhje me Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës, të cilat i janë referuar një fëmije si “çdo person i lindur gjallë i cili është nën moshën 18 vjeçare «. Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës gjithashtu përcakton të gjitha të drejtat dhe mbrojtjen e një fëmijë dhe të drejtat e tij, dhe emrat i institucioneve dhe mekanizmave që janë përgjegjës për garantimin e realizimit të këtyre të drejtave. Këto janë Agjencia Kombëtare për Këshillin Kombëtar dhe Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijës, të cilat janë vendosur deri në vitin 2010. Ligji gjithashtu parashikon ngritjen e njësisive të mbrojtjes së fëmijëve në nivel rajonal dhe lokal, për të shërbyer si njësi primare për rastet e shkeljeve të të drejtave të fëmijëve. Sipas Kushtetutës, fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti. I njëjti nen thekson se çdo fëmijë ka të drejtën e mbrojtjes nga dhuna dhe shfrytëzimi që mund të dëmtojë shëndetin apo të vërë jetën e saj dhe zhvillimin e tij normal në rrezik.

Sipas Kodit të Familjes, moshë minimale ligjore që një shtetas shqiptar mund të kryejë një martesë është moshë 18 vjeç. Megjithatë, sipas të njëjtit nen i Kodit të Familjes bazuar në miratimin e një gjykate lokale, një martesë mund të kryejnë edhe fëmijët nën 18 vjeç për çështje të rëndësishme, për shembull; në qoftë se, kur një vajzë nën 18 vjeç është shtatzënë, apo burri i ardhshëm është një emigrant që do të donte për të kontraktuar një martesë me një person nën 18 vjeç. Në këtë rast nuk ka moshë minimale të përcaktuar. Sipas dhe bazuar në ratifikimin e të gjitha instrumenteve ndërkombëtare, në shtetin shqiptar, sipas legjislacionit shqiptar të gjitha martesat duhet të bazohen në pëlqimin e lirë të dy bashkëshortëve të ardhshëm, dhe duhet të jenë të regjistruar në një zyrë zyrtare regjistrat.

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë thekson se një person arrin kapacitetin e plotë juridik kur ai ose ajo arrin 18 vjeç. Kodi specifikon, megjithatë, se në qoftë se një vajzë martohet para moshës 18, ajo automatikisht arrin kapacitetin juridik. Kapaciteti ju-

ridik i jep një personi të drejta dhe detyrime të caktuara ligjore; për shembull, për të hyrë në kontrata ligjërisht të detyrueshme, të marrë trajtim mjekësor pa pëlqimin e prindërve, dhe për të regjistruar lindjen e fëmijëve.

Megjithatë Kodi Penal nuk e kriminalizon martesën e fëmijëve. Është një referencë në Kodin Penal në nenin 130 ku thuhet se detyrimi me forcë në fillimin ose vazhdimi i një bashkëjetese si dhe kërkesa e një të rrituri për të shkuar jashtë territorit të shtetit shqiptar me një fëmijë në mënyrë që të detyroj atë të kryej martesë, dënohet me gjobë ose deri në tre muaj burg.

Sipas të njëjtit Kodit Penal, në nenin 100, marrëdhënia seksuale me një të mitur nën moshën 14vjeç është një vepër penale, dhe ka një dënim prej shtatë deri në 15vjet burg; ndërsa kryejra e marrëdhënieve seksuale të detyruar me një të mitur të moshës 14-18 vjeç, dënohen nga pesë deri në 15 vjet burgim.

3.3 Shteti Palë, *Shoqëria Civile* dhe Fëmijët raporti i Asamblesë së 61 të Komitetit mbi të Drejtat e Fëmijës (17 shtator - 5 tetor 2012)

Shqipëria ratifikoi Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF) në 27 shkurt 1992. Më 25 Shtator 2012, Komiteti për të Drejtat e Fëmijës shqyrtoi raportin e dytë të tretë dhe të katert periodik të kombinuar të Shqipërisë. Shqipëria u përfaqësua nga Delegacioni i Shqipërisë, i cili ishte i përbërë nga përfaqësues të lartë të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe i Misionit të Përhershëm të Shqipërisë në Kombet e Bashkuara zyra në Gjenevë. Në këtë prezantim përfaqësuesit e Shqipërisë prezantuan ligjin e ri për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës të lëshuar më 4 nëntor 2010 dhe Planin e Veprimit për Fëmijët 2012-2015 si një hap përpara për përmbushjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Për herë të parë në këtë raport, krijimi i njësisive të të drejtave të fëmijës në nivel lokal dhe Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fë-

mijës u prezantuan dhe u ngarkuan për monitorimin dhe zbatimin të të ligjit dhe Planit të Veprimit për Fëmijët.

Kreu i delegacionit theksoi progresin që Shqipëria ka bërë në fushën e shëndetësisë, arsimit, strehimin familjar dhe mbrojtjen e fëmijëve. Delegacioni përmendi uljen e vdekshmërisë foshnjore, kujdesin e përmirësuar për ligjin e sapo të lindurve dhe ligjin e ri për arsimin parauniversitar. Ata gjithashtu theksuan bashkëpunimin e mirë me shoqërinë civile, e cila kishte qenë në gjendje të japi të dhëna gjatë hartimit të ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Lidhur me çështjen e marteave të hershme në Shqipëri, Komiteti i kishte dhënë një listë të çështjeve që lidhen me informacion shtesë dhe të përditësuar, në të cilën Shtetit Palë iu kërkohatë paraqiste me shkrim, informacion shtesë të përditësuar në lidhje me temat. Në paragrafin 3 të Pjesës I, Komiteti kërkoi nga shteti që tijaftë informacion mbi masat specifike të ndërmarra për të adresuar problemin e martesave të hershme të cilat thuhet se janë ende të zakonshme në komunitete të caktuara. Përgjigja e shtetit në këtë pikë ishte:

*Lidhur me problemin e martesave të hershme të komunitetit Rom ne përmendim se Ligji i Familjes, neni 7 siguron martesë midis një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Vetëm për arsye të një rëndësie të madhe, mund gjykata të lejojë martesën para se të arrijnë këtë moshë. Kjo fushë është e rregulluar tashmë me dispozitat e ligjit të familjes që nuk i lejojnë martesat në moshë të re. Në të vërtetë edhe strukturat shtetërore kanë bashkëpunuar me Romët dhe organizatat jofitimprurëse Rome, të cilat adresohen në këtë problem përmes fushatave ndërgjegjësuese për të rritur ndërgjegjësimin e komunitetit Rom në mënyrë për të minimizuar martesat në moshë të re në këtë komunitet*⁸

⁸ Komiteti i të Drejtave të Fëmijëve, Sesioni i gjashtëdhjetë e një, Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, Lista e tematikave përsa i përket informacionit të shtuar dhe të rifreskuar, lidhur me shqyrtimin e dytë të kombinuar, raportet periodike të dyta dhe të treta për Shqipërinë. (CRC/C/ALB/2-4), Përgjigjet e shkruara për Shqipërinë.

Sipas grupit të OJQ-ve të KDF (2012) përgjigjet e Delegacionit për këtë çështje ishin se martesat e hershme nuk ishin të zakonshme në zonat rurale, por kanë qenë shqetësuese në komunitetet Rome si një një element i kulturës së tyre. Janë bërë përpjekje për të adresuar këtë prirje, duke e përfshirë në Planin Kombëtar të Veprimit për përfshirjen e komunitetit Rom në arsim. Sipas Planit Kombëtar të Veprimit për Dekadën e Përfshirjes së Romëve 2010-2015, martesat e hershme nuk janë përmendur në asnjë nga prioritetet, si dhe objektivat e Planit të Veprimit Kombëtar. Një tjetër raportim erdhi nga bisedimet, intervista, pyetësorë, ëorkshop-et, trajnimet, dhe takimet që Bashkimi për Kujdesin e Fëmijëve dhe Koalicioni I Mbrojtjes (BKTF), që ka bërë me 26 fëmijë që u mbledhën në Durrës më 15, 16 dhe 28, 29 tetor 2011 dhe që përfaqësojnë 14,534 fëmijë nga Tirana, Vlora, Durrësi, Kuçova, Elbasani, Peshkopia dhe Dibra. Shqetësimi i tyre në lidhje me çështjen e martesës së hershme të fëmijëve është se në shumë familje shqiptare fëmijët përdoren për punë të rënda; ata emigrojnë; ose janë përjashtuar nga vendimet e rëndësishme në jetën e tyre. Ka pasur raste të martesave me shkuesi për vajzat e vogla, pa pëlqimin e tyre. Fëmijët që nuk kanë kujdes prindëror hasin shumë vështirësi për tu përshtatur në shoqëri; ata nuk kanë një strehim të sigurt, ushqim dhe siguri; ata nuk përfitojnë nga sistemi i kujdesit shëndetësor dhe shumë prej tyre përfundojnë duke braktisur shkollën. Martesa e hershme është një shkëlqje e të drejtave të tyre sipas KDF.

Vëzhgimet dhe rekomandimet përfundimtare të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve

Pas raportimit të aktorëve të ndryshëm (shtetet pale dhe raportet plotësuese të aktorëve të tjerë) në Komisionin e OKB-së për situatën e të drejtave të fëmijës, përsa i përket zbatimit dhe shkëlqjeve të këtyre të drejtave, martesat e hershme janë kategorizuar si një “Praktikë e dëmshme” nga komiteti dhe rekomandimi i komisionit në lidhje me këtë çështje ishte si vijon:

Komiteti, ndërsa vë në dukje se mosha minimale ligjore e martesës është caktuar në moshën 18 vjeç, shpreh shqetësimin për praktikë të vazhdueshme të martesave të hershme dhe të detyruara, posaçërisht në komunitetin Rom.

Vazhdimi i procesit pas vërejtjeve dhe rekomandimeve të Komitetit

Pasi Komiteti ka dorëzuar rekomandimet për Shqipërinë në mbylljen e raportimit, në Tetor 2012, gjatë kësaj periudhe në kuadër të studimit, Observatori ka kontaktuar shumë institucione shtetërore dhe jo-shtetërore për të pyetur nëse është ndërrmarre ndonjë hap konkret nga Qeveria Shqiptare ose të Shoqëria Civile për të lehtësuar gjendjen e fëmijëve në Shqipërinë lidhje me çështjen e martesave së hershme të fëmijëve. Disa nga përfaqësuesit e partnerëve të shoqërisë (Institucione shtetërore dhe shoqëri civile), nuk kishin informacion të përditësuar në lidhje me çështjen e martesave të hershme të fëmijëve, me përjashtim të disa studimeve të realizuara nga organizata partnere (OJF) në disa zona të Shqipërisë. *Në bazë të informacioneve tona nga tetori 2012, deri shkurt 2015 nuk është ndërmarrë asnjë masë lehtësuese për të studiuar dhe parandaluar këtë fenomen.*

4. Faktorët që kontribuojnë në Martesat e Hershme të fëmijëve dhe efektet që këto martesë sjellin ⁹

Martesa e hershme dhe sjellja e fëmijëve në përgjithësi pasqyrojnë traditatën e komunitetit Rom në lidhje me martesën dhe rolin gjinor. Ata presin që femrat të jenë bashkëshorte dhe nëna. Përveç kësaj, vajzat dhe djemet janë shumë pak të informuar në lidhje me metodat e planifikimit familjar. Si rezultat, përdorimi i metodave kontraceptive është i ulët, dhe nga ana ana tjetër normat

⁹ De Soto H., S. Beddies, dhe I. Gedeshi (2005) 'Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri: Nga përjashtimi social në përfshirjen sociale, Banka Botërore, Washington D.C., faqja28

e abortit janë të larta. Efektet kryesore të martesave të hershme dhe lindjet e fëmijeve në moshë të re, rezultojnë me nivel të ulët të arsimit dhe me norma të larta të divorcit. Për Romët, normat e divorcit janë më të larta se për pjesën tjetër maxhoritare të vendit. Për gratë, divorci çon në rritjen e varfërisë dhe përjashtimit social për ato vetë, familjet dhe fëmijët e tyre. Kjo mund të rezultojë në një tërheqje në prostitucion si një strategji për të mbijetuar dhe një mekanizëm për rballimin e varfërisë.

4.1 Faktorët kryesorë që cojnë në Martesa të Fëmijëve

Moshat e hershme të martesës vijnë nga aderimin i normave kulturore dhe rolet gjinore tradicionale, varfëria, frika e prindërve për rrëmbim dhe prostitucionin, dhe pak njohuri për planifikimin familjar. Ndikimi i këtyre normave dhe vlerave të moshave martesore është veçanërisht i fortë për gratë. Shkaqet kryesore të martesës së fëmijëve në mesin e romëve duhet të trajtohen. Martesa e fëmijëve nuk është një ngjarje e izoluar. Ajo është e lidhur me probleme të tjera sociale me të cilat përballen familjet rome, të tilla si vështirësi ekonomike, mungesa e strehimit të përshtatshëm, dhe mungesa e qasjes në shërbimet arsimore dhe shëndetësore, mungesa e informacionit rreth planifikimit familjar.

4.1.1 Normat kulturore dhe Vlerat

Gratë Rome pritet që të martohen herët dhe të kenë fëmijë. Prindërit mendojnë se “e drejta” mbi vajzat e tyre për të lidhur në martesë bie me moshën. Ata besojnë se kur vajza është 18-19 vjeç dhe ajo është e pa martuar, diçka nuk shkon me këtë vajzë. Një arsye tjetër e martesës së hershme, është shenjtëria e virgjërisë femërore, e cila në kulturën rome është përkthyer si “besnikëri e vajzës ndaj burrit të saj”.

Një nga ndikimet mbi gratë dhe presioni i familjes është për të pajtuar gratë e ndara nga burrat e tyre. Edhe ata në martesat abuzive nxiten shpesh nga anëtarët e familjes për të duruar abuzimin e jo të

ndahen. Në fakt, anëtarët e familjes ndërhyjnë që të pajtojnë çiftet, edhe kur gratë në martesat abuzive të bëjnë të pamundurën për të lënë burrat e tyre. Në kontrast me romët, normat kulturore shqiptare dhe vlerat kanë qenë subjekt i shumë ndryshimeve gjatë të njëjtës periudhë. Faktorët e përgjithshëm në lidhje me normat kulturore janë¹⁰:

- presioni i kulturës patriarkale;
- Rëndësia e ruajtjes së nderit të vajzës dhe virgjërisë;
- Vendi i burrit në familje dhe roli që luan vjehrra;
- Sigurimi i një imazhi para grupit / komunitetit;
- Dëshira e prindërve për të siguruar se të rinjtë nuk do ta humbasin vlerat e tyre kulturore dhe tradicionale dhe mos të bëhet shumë “moderne”;
- Shkaqe të arsyeshme fetare për të ruajtur imazhin dhe rolin e gruas;
- Ndikimi i racizmit në komunitet e cila çon në komunitete kompakte, pa socializim të përzier;
- Shqetësimi idisa familje ‘në lidhje me “përzierjen” e martesave; etj

4.1.2 Varfëria

Varfëria është parë si faktor kryesor ekonomik për komunitet Rom dhe martesat e hershme. Në shumë raste martesat e hershme janë pare si një tjetër mekanizëm për të përballuar varfërinë. Shumë prindër të varfër janë të detyruar të martojnë vajzat e tyre në moshë të re për të lehtësuar vështirësitë e tyre ekonomike. Gratë e martuara jetojnë me burrat e tyre, dhe shpesh me familjet e burrave të tyre, kështu që martesat e vogëlona numrin e vartësve brenda familjes e gruas.

4.1.3 Frika nga rrëmbimi dhe prostitucioni

Frika e rrëmbimit dhe prostitucionit të mundshëm bën që mar-

10 Bitu. N and Morteau.C (2010), *Are the Rights of the Child Negotiable? The Case of Early Marriages within Roma Communities in Romania, Bucharest*, ISBN 978-973-139-143-4, fq.29

tesat e hershme të jenë një zgjedhje për prindërit romë. Prindërit mendojnë se vajzat e pamartuara, gratë e pashoqëruara janë më të prirura për të folur me të huajt. Lidhja e perceptuar midis prostitucionit dhe martesave të hershme është e lartë.

4.1.4 Kontrolli i lindjeve

Metoda e kontrollit të lindjes është e rrallë në mesin e këtyre grupeve. Kontrolli i lindjeve në komunitetin Rom është në një përqindje mjaft të ulët. Kontrolli i ulët i lindjeve është pjesërisht rezultat i mosbesimit, dhe mungesës së njohurive rreth metodave të kontrollit të lindjes. Shumica e grave Rome mendojnë se metodat e përdorura për kontrollin e lindjes nuk janë të besueshme dhe dëmtojnë shëndetin e tyre. Fakti që gratë Rome nuk kanë njohuritë e duhura, ose nuk i përdorin metodat e kontrollit të lindjes, është i lidhur ngushtë me faktin se numri i aborteve në mesin e grave Rome është shumë i lartë. Në shumë raste kjo ndodh për shkak se burrat e tyre nuk duan që gratë të përdorin kontraktive, ata i dhunojnë ato, kur kuptojnë se gratë janë duke përdorur kontraktive. Në shumicën e rasteve abortet kryhen nga mjeku, dhe në shumë raste të tjera ato kryejnë aborte vete.

4.2 Efektet e martesave të Hershme

Martesat e hershme janë një kërcënim i madh për të drejtat e njeriut dhe mirëqenien e fëmijëve. Ato i mohojnë të rinjve mundësitë për t'u rritur dhe fuqizuar veten. Ajo sfidon të drejtën themelore të këtyre fëmijëve në arsim, shëndetësi, mbrojtje dhe zhvillim. Disa nga efektet që martesat e fëmijëve sjellin janë:

4.2.1 Nivel i ulët arsimor

Në martesat e hershme të fëmijëve, vajzat dhe gratë e lënë shkollën shumë herët që të kujdesen për burrat, familjen dhe fëmijët e tyre. Pra, martesat e hershme është e lidhur fort me braktisjen dhe

me nivele të ulëta të arsimit. Ndërkohë që shumë vajza dhe gra rome nuk shkojnë të gjitha në shkollë, dhe ato që e vazhdojnë hkollën e braktisin atë herët për të kryer detyrat e familjes kur ata të angazhohen në martesë. Në shumë raste, priti ja e vajzave para moshës 18 vjeç për tu lidhur në martesë, është dhe shkak për ta për të lënë arsimin që në nivelet e ulta, dhe të qëndrojnë në shtëpi në pritje dhe duke u përgatitur për funksionet e tyre si nëna dhe bashkëshorte. Disa nga pasojat e këtyre zgjedhjeve janë shkalla e lartë e analfabetizmit, kualifikimet e ulëta, dhe fare pak (nëse ka) aftësi të dobishme profesionale.

4.2.2 Kujdesi i pakët për fëmijët

Kur gratë martohen të reja dhe behen me fëmijë, cilësia e kujdesit të fëmijëve ka tendencë të jetë më e ulët se sa për gratë me te medha ne moshe. Shumë nëna te reja janë ende të fëmijë vete dhe nuk kanë asnjë kuptim të kërkesave të kujdesit të fëmijëve. Duket se vjehrrat janë gjithashtu përgjegjëse për temësuar nuset e tyre për bazat ne kujdesjen e femijeve.

4.2.3 Rritja e përqindjes së divorceve

Martesat e hershme dhe martesat e rregulluara zakonisht janë identifikuar si një shkak i divorcit, pasi bashkëshortët dinë shumë pak për njëri-tjetrin para se të martohen. Në shumicën e rasteve njëri prej bashkëshortëve ose të dy, nuk e mbështetin dhe nuk e pranojnë martesën. Këto lloje të martesash nuk janë të bazuara në njohjen me njëri-tjetrin, kështu që kjo është ajo lloj martese e cila përfundon në divorc. Martesa e hershme mund te përfundojë deri në abuzimin bashkëshortor. Edhe pse Romet besojne se martesat e kryera në moshë të hershme ndihmojnë në përmirësimin e jetës së çiftit duke qenë se ato rriten së bashku, praktika ka treguar të kundërtën. Kur gratë arrijnë në një moshë të caktuar dhe ato jane rritur se bashku, dhe ato ende vazhdojnë të vuajnë nga dhuna e bashkëshortit të tyre, vjen një moment kur ato arrijne nje moshe pjekurie dhe denoncojnë këtë abuzim.

4.2.4 Arsimi dhe ekonomia:

Për shkak se vajzat e reja janë të martuar herët, pak ose aspak fokusi i jepet edukimit të tyre, duke shkuar vulgarisht kundër thënies, “duke edukuar një grua keni edukuar një familje, duke edukuar një familj ekeni edukuar një komb”. Duke lënë brezat e ardhshëm pa shkollimin e duhur, cikli i varfërisë vazhdon dhe në këtë mënyrë, kufizon rritjen e përgjithëshme ekonomike të kombit. Femrat me nivele më të lartat ë shkollimit kanë më pak të ngjarë të martohen herët.

4.2.5 Seksualiteti dhe dhuna

Vajzat e reja me nivel të ulët të shkollimit kanë më shumë gjasa të përjetojnë dhunë nga partneri intim. Një vajzë e re që është ende duke luftuar për të kuptuar anatomine e saj është e detyruar të kryejë marrëdhënie bashkëshortore dhe shpesh tregojnë shenja të stresit post-traumatik dhe depresioni për shkak të abuzimit seksual nga partneri i saj i vjetër. As trupat dhe as mendjet e tyre të pafajshme nuk janë të përgatitur. Marredheniet seksuale të detyruara çojnë në dëmtime të pakthyeshme fizike. Dëmi psikologjik mund edhe të mos kuptohet. Vajzat kanë tre herë më shumë gjasa të përjetojnë përdhunimin martesor. Vajzat që martohen pas 18 vjetësh kanë më shumë gjasa për të biseduar me burrat e tyre për kontraceptivët, të diskutojnë kur të kenë fëmijë dhe sa. Nuset e reja përballen me një rrezik më të lartë të HIV-it dhe sëmundjeve të tjera seksualisht të transmetueshme për shkak të martesës së saj me një burrë të vjetër që ka patur marredhenie seksuale.

Vajza të reja që janë më pak se 15 vjeç kanë pesë herë më shumë gjasa të vdesin gjatë lindjes së fëmijëve të tyre se sa ato që janë në moshën 20 vjeç e sipër. Shkalla e vdekshmërisë foshnjore është shumë më e lartë sepse trupi i ri i një gruaje nuk është biologjikisht i aftë të luajë rolin dhe detyrimet e nënës.

Për shkak të moshës së tyre të brishte, një pjesë e tyre janë shfrytëzuar seksualisht nga burrat e tjerë në familje dhe ato janë shumë të frikësuar për tu ankuar. Në mungesë të arsimimit të duhur, pak nga ato

është e informuar se gjinia e fëmijës varet nga babai dhe jo nga nëna.

4.2.6 Rreziku i shëndetit

Ekziston një lidhje e drejt për drejtë midis marrëdhënieve martesore dhe shëndetit fizik. Zakonisht, martesat e hershme janë parë në vendet në zhvillim dhe femijet nuse mund të përballen me çështje serioze e kërcënuese për jetën. Vajzat e reja që janë martuar në moshë të re janë të ekspozuara në lindjen e shpeshte të fëmijëve, shtatzënitë e pa planifikuara, sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe abortet që janë të dëmshme për shëndetin e tyre dhe statusin e ushqyerjes. Si rezultat, fëmijët e lindur nga nënat që kanë një status të dobët të ushqyerjes, janë në rrezik për të pasur fëmijë me peshë të ulët në lindje, si dhe mund të krijohen dhe probleme të zhvillimit të vonë të fëmijës.

5. Analiza lidhur me fenomenin e martesave të hershme në Shqipëri-Një vështrim i vecantë për Komunitetin Rom

Kjo pjesë e këtij studimi është fokusuar shumë në analizat në fenomenin e martesave hershme me vështrim të vecantë dhe krahasim me komunitetin Rom. Të dhënat e prezantuara janë marrë nga regjistrimet e bëra në vitin 2011 për gjithë popullsinë Shqiptare nga INSTA dhe për Komunitetin Rom nga harta e Romëve 2011.


Analiza është fokusuar në 4 dimensione. Analiza e dimensionit të parë janë të dhëna të përgjithshme për martesat në shoqëronë Shqiptare opërsa I përket mesatares së moshës së martesës, mesatarja e moshës, përbërja e familjes dhe si këto të dhëna dhe trende kanë ndryshuar me kalimin e viteve duke treguar në të njëjtën kohë ndryshimet që ka kaluar shoqëria jonë gjatë gjithë këtyre viteve. Arsyeja se pse ne I kemi dhënë fokusin kësaj hapësire është që të tregojmë se edhe pse shoqëria Shqiptare ka kaluar një seri ndryshimesh në kuptimin e konceptit për martesën, fenomeni I martesave të hershme akoma ekziston në tëb njëjtën formë. Duke folur përgjithësisht për analizën e kësaj pjese, mesatarja e moshës për shoqërinë Shqiptare në lidhje

me martesat është rritur, përqindja e martesave mbi 20 vjeç është ulur dhe dhe madhësia mesatare e familjes është ulur. Përkundër të gjitha këtyre ndryshimeve kulturore fenomeni i martesave të fëmijëve ende ekziston dhe kjo është më e dukshme në kulturën e komunitetit Rom. Pjesa e dytë analizon fenomenin e martesave të hershme në shumicën shqiptare. Pjesa e tretë analizon fenomenin e martesave të hershme në komunitetin Rom dhe pjesa e katërt dhe e fundit analizon pjesën që zënë martesat e hershme në komunitetin Rom në fenomenin e martesave të fëmijëve në shoqërinë shqiptare.

5.1 Dimensioni i parë- Një vështrim lidhur me martesat në shoqërinë shqiptare

Duke folur për të dhënat e përgjithshme, sipas INSTAT, përqindja e martesave mbi 20 vjeç për vitin 2013 në popullatën maxhoritare, rezulton të jetë 2 %, nga të cilat: 2,3 % janë meshkuj dhe 1.8 % femra. Siç tregohet në grafikun nr. 1 prirje në përqindje të martesave për një vit në Shqipëri ka rënë me 1 % nga viti 2001.

Grafiku 1: Përqindja e martesave mbi 20 vjeç e sipër (2001 – 2013)




Burimi: INSTAT (2015) – Numri i martesave mbi 20 vjeç e sipër dhe numri në total i popullatës Llogaritjet e bëra nga autori

Në vitin 2001 përqindja e martesave në shqipëri ishte 3%, dhe në vitin 2013 përqindja e martesave ishte 2%. Një rënie e fortë në përqind-

je e martesave është regjistruar në vitin 2006 dhe 2008 nga 1.9%.

Sipas INSTAT një trend të martesave bazuar në grupmoshat mbi 19 vjeç kurba ka pësuar rritje dhe pastaj zbritje. Pjerrësia e kurbës ndryshon sipas grupmoshave. Grafiku numër 2 tregon përqindjen e martesave bazuar në moshën sipas seksit.

Grafiku 2: Përqindja e martesave sipas seksit dhe grupmoshave për vitin 2013.



Burimi: INSTAT (2015) –Numri i martesave për vitin 2013

Llogaritjet e bëra nga autori

Nga grafiku numër 2, mund të shohim se përqindja e martesave rritet në varësi të moshës mbi moshën 29 vjeç. 25-29 vjeç, ky grup është mbi mesataren e popullatës, grupi më shumë i predisposuar për martesë është 33% e popullatës. Deri në atë moshë pjerrësia e kurbës për martesat vazhdon rritjen, duke filluar me një mesatare prej 12% për martesat mbi 19 vjeç dhe duke vazhduar me një rritje me 18% për moshën 20-24 vjeç. Pas moshës 25-29 vjeç pjerrësia e kurbës për martesat ulet ndjeshëm mbi 16% për moshën 30-34 vjeç, dhe vazhdon ulet ndërkohë që moshja rritet.


Megjithatënese analizojmë trendin e martesave bazuar në gjini, ne mund të shohim se shumica e femrave kanë tendencë të martohen në grupmoshën 20-24 vjeç, që shpjegohet me një përqindje të lartë të

femrave duke u martuar në atë moshë me 42%, dhe me shkujt kryesisht martohen në grupmoshën 25-29 vjeç; Kjo shpjegohet me përqindjen e lartë të meshkujve duke u martuar në atë moshë deri 43%. Pjerrësia e kurbës së martesës për femrat rritet deri në grupmoshën 20-24 dhe pastaj zvogëlohet, dhe pjerrësia e kurbës së martesës për meshkujt rritet deri në 25-29 vjeç dhe pastaj zvogëlohet.

Një tjetër fakt që vërehet nga grafiku nr. 2 është se diferenca e meshkujve dhe femrave duke u martuar deri në 19vjeç është shumë e thellë, me 23 pikë përqindje të larta për femrat. Përqindja e femrave të martuara deri në moshën 19 vjeç është 24%, ndërsa te meshkujt është vetëm 1 %.

Grafiku numër dy jep një shpjegim të shkurtër rreth moshës mesatare që shoqëria shqiptare shkon në martesë. Kjo shkon paralel me grafikun numër 3, i cili jep një informacion të detajua rreth moshës mesatare që meshkujt dhe femrat Shqiptare martohen.

Grafiku 3: Moshja mesatare e martesës sipas gjinisë, 2000 - 2013



Burimi: INSTAT (2015)


Siç mund të vërehet nga grafiku nr. 3, mesatarja e moshës në të cilën meshkujt dhe femrat shqiptare martohen, është rritur ndjeshëm nga viti 2000 deri në vitin 2013. Për meshkujt moshja mesatare ka qënë të 28,1 vjeç në vitin 2000, dhe është rritur në 30,5 vjeç. Për femrat moshja mesatare ka qënë 23 vjeç në vitin

2000 dhe është rritur në 24,9 vjeç në vitin 2013. Kjo është pare qartë se dallimi në moshë në të cilën meshkujt dhe femrat martohen është rritur, nga viti 2000 deri në vitin 2013. Në vitin 2000 dallimi në moshën mesatare ndërmjet meshkujve dhe femrave ishte 5,1 vjeç dhe në vitin 2013 ajo është rritur në 5,6 vjet.

Nëse krahasojmë të dhënat nga grafiku 2 dhe grafikun 3, mund të themi se edhe pse moshë mesatare në të cilën femrat janë martuar në vitin 2013 është 24,9 vjeç, shumica e femrave (42% prej tyre) janë martuar në grup moshën 20-24 vjeç në vitin 2013. E njëjta gjë është për meshkujt, edhe pse moshë mesatare për meshkujt është 30,5 vjeç, shumica e meshkujve (43% prej tyre) janë martuar në grup moshën 25-29 vjeç.

Sipas Studimit të Matjes së Nivelit të Jetesës (LSMS) të ndërmarrë nga INSTAT në vitin 2002, 2005, 2008 dhe 2012 madhësia mesatare e familjes në shoqërinë shqiptare ka rënë në vitin 2002-2012 me 0,4 anëtarë. Siç mund të vërehet nga grafiku nr. 4, në vitin 2002 madhësia mesatare e familjes ishte 4,3 anëtarë dhe në 2012 ajo ka rënë në 3,9 anëtarë.

Grafiku 4: Madhësia mesatare e familjes në shoqërinë Shqiptare (2002-2012)




Burimi: LSMS (2002, 2005, 2008 & 2012)

5.2 Dimensioni i dytë -Martesate e hershme në Shoqërinë Shqiptare

Në qoftë se do të shkonim më thellë temës së martesave të hershme në Shoqërinë Shqiptare, për shkak të mungesës së studi-meve mbi këtë temë dhe të mungesës së të dhënave të përditësuara mbi martesat e fëmijëve, kjo pjesë e studimit është i bazuar në të dhënat që dalin nga Regjistrimi i Popullsi së shqiptare në vitin 2011. Ky lloj i të dhënave mund të mblidhen vetëm nga intervistat e bëra në çdo shtëpinë në të gjitha zonat e vendit, pjesë e cila mbulon regjistrimin e gjithë popullsisë, proces i cili së fundmi për Shqipërinë kanë qënë në vitin 2011.

Bazuar në të dhënat e regjistrimeve të viti 2011, siç është reflektuar dhe në grafikun 5, shumica e fëmijëve Shqiptarë janë beqar dhe ato përfaqësojnë 96.9% ose 6179 të moshës 15-18 vjeç. Pjesa tjetër e fëmijëve të moshës 15-18 vjeç të cilët janë të martuar është 2.92% ose 186 fëmijë, e cila është një vlerë e konsiderueshme. Tre kategoritë e tjera që janë me statusin të martuar janë fëmijë të divorcuar e cila zë 0.05% ose 3 fëmijë nga moshja 15-18 vjeç, fëmijët e ve zënë 0.14% ose 9 fëmijë të moshës 15-18 vjeç dhe fëmijë jo të ndarë ligjërisht që zënë 0%.

Grafiku 5: Statusi martesor i fëmijëve (15-18 vjeç) në të gjithë popullsinë – 2011




Burimi: Regjistrimi i popullsisë Shqiptare – INSTAT (2011)

Llogaritjet e bëra nga autori

Nëse do të vëzhgoj në gjendjen civile të fëmijëve në moshën 15-18vjeçare të ndara sipas gjinisë (Grafiku nr. 6), në mënyrë që të marrim një pasqyrë secila gjini ka efekt më të madh në secilën prej kategorive, ne mund të konkludojmë se fëmijët meshkuj zënë pjesën më të madhe në kategorinë beqar,nga 98,1% në krahasim me fëmijët femra me 95,7%; femrat nga mosha 15-18 vjeçare zënë pjesën pjesën më të madhe të fëmijëve të martuar me 4,1% (127 vajzave), në krahasim me fëmijët meshkuj me 1,8% (59 djem). Ne mund të themi se fëmijët meshkuj kanë përqindje më të larta në të dy kategoritë e tjera, si dhe nga 0,06% të fëmijëve meshkuj të divorcuar krahasuar me 0,3% e fëmijëve të divorcuar femra dhe 0,06% të fëmijëve meshkuj të ve, krahasuar me 0,22% e fëmijëve femrave të ve.

Grafiku 6: Statusi martesor i fëmijëve nga mosha (15-18 vjeç) për të gjithë popullsinë, sipas gjinisë – 2011




Burimi: Regjistrimi in popullsisë Shqiptare – INSTAT (2011)

Llogaritjet të bëra nga autori

Nëse do të analizojmë çështjen e martesave të fëmijëve të ndarë në kategori sipas Gjendjes Civile (të martuar, të divorcuar dhe të ve) dhe në bazë të grup moshës (15 deri në 18 vjeç) siç tregohet dhe në grafikun 7, mund të themi se përqindja e fëmijëve të martuar rritet me moshën. Kjo do të thotë se përqindja e fëmijëve 15 vjeçarë të martuar është 2% dhe kjo është më e ulët se përqindja e fëmijëve 18vjeçarë të martuar që është 6%. Megjithatë, pothuajse në të gjitha grupmoshat përqindja e vajzave të martuara është më e lartë se sa ajo e djemve të martuar.

Grafiku 7: Përqindja e fëmijëve të martuar në total e ndarë sipas moshës dhe gjinisë – 2011




Burimi: Regjistrimi i popullatës në Shqipëri – INSTAT (2011)

Llogaritjet e bëra nga autori

Bazuar në të dhënat e regjistrimeve të vitit 2011, fenomeni I fëmijëve të divorcuar (grafiku nr. 8) është parë vetëm për grup moshën 15 dhe 16 vjeç. Ashtu si në kategorinë e fëmijëve të martuar, përqindja e fëmijëve të divorcuar rritet me moshën dhe gjinia më e prekur janë femrat.

Grafiku 8: Përqindja e fëmijëve të divorcuar në total e ndarë sipa moshës dhe gjinisë – 2011




Burimi: Regjistrimi i popullsisë shqiptare – INSTAT (2011)

Llogaritja sipas autorit

Ashtu si në të gjitha fushat, femrat janë më të prekurat tek kategoria fëmijë vejusha (grafiku nr 9). Përqindja më e lartë është dalluar në grup moshën 17 vjeç me 0.25%.

Grafiku 9: Përqindja e fëmijëve të ve në të gjithë popullatën e ndarë sipas moshës dhe gjinisë – 2011



Burimi: Regjistrimi i popullsisë shqiptare – INSTAT (2011)
Llogaritja sipas autorit

5.3 Dimensioani i tretë -Martesat e hershme në komunitetin Rom


Bazuar në faktin se komuniteti Rom është komuniteti më i prekur nga fenomeni i martesave të hershme, ne i kemi kushtuar vëmendje të vecantë analizës për martesat e hershme në këtë komunitet. Të dhënat për martesat e hershme të romëve në Shqipëri janë marrë nga Harta e Romëve e vitit 2011.

Informacionet për martesat e fëmijëve Rom janë më të hershme se ato të pjesës më të madhe të fëmijëve të tjerë. Martesat e fëmijëve Rom fillojnë nga moshja 13 vjeç. Siç shihet dhe në grafi-

kun nr. 10 përqindja e fëmijëve beqar në moshën nga 13-18 vjeç në komunitetin Rom është 76% ose 1488 fëmijë dhe është shumë e ulët krahasuar me martesat e hershme në pjesën më të madhe të Shqipërisë e cila është 96.9%. Kështu që përqindja e kategorive të tjera (të martuar, të divorcuar dhe ata që bashkëtojnë) është më e lartë në numër për këtë komunitet. Përqindja e martesave të hershme në komunitetin Rom është 9% ose 180 fëmijë dhe është më e lartë se pjesa më e madhe e popullsisë që është 2.9%. Përqindjen më të madhe në komunitetin Rom e zënë fëmijët që bashkëtojnë të cilët zënë 14% ose 275 fëmijë.


Grafiku 10: Statusi i martesave tek fëmijët Rom 13-18 vjeç) – 2011

Statusi martesor i fëmijëve Rom (13 -18 vjeç) 2011




Burimi: Harta Rome (2011) Llogaritjet nga autori

Në qoftë se analizojmë kategoritë në mënyrë më të detajuar, shohim që nga grafiku numër 11, përqindja e fëmijëve beqarë ulet me moshën. Përqindja e fëmijëve beqarë është më e lartë në moshën 13 vjeç (97.3%) sesa në moshën 18 vjeç që shkon në 55.8%. E kundërta ndodh me fëmijët e martuar (grafiku nr. 11). Përqindja të fëmijët e moshës 13 vjeç të martuar është më e ulët (0.7%) krahasuar me fëmijët e moshës 18 vjeç (18.1%).

Grafiku 11: Përqindja e fëmijëve Rom beqarë (13-18 vjeç) – 2011

Burimi: Harta Rome (2011) Llogaritjet nga autori


Grafiku 12: Përqindja e fëmijëve Rom të martuar (13-18 vjeç) – 2011

Burimi: Harta Rome (2011) Llogaritjet nga autori

Kategoria e fëmijëve që bashkëjetojnë ka një rëndësi të madhe në fenomenin e fëmijëve të martuar dhe është një kategori ku përfshihen si fëmijët e martuar ashtu edhe ata beqar. Ata ndonjëherë janë konfuz dhe e deklarojnë veten si të martuar, duke u futur në kategorinë e fëmijëve të martuar. Sic është treguar edhe në grafikun nr. 13, kjo kategori shkon deri në 25% të fëmijëve Rom ose 79 fëmijë. Përqindja e fëmijëve që bashkëjetojnë rritet me moshën. Kjo kategori fillon me 1.7% në moshën 13 vjeç, fëmijët Rom të cilët bashkëjetojnë, dhe mbaron me 25% në moshën 17 vjeç të fëmijëve Rom të cilët bashkëjetojnë.

Grafiku 13: Përqindja e fëmijëve Rom të cilët bashkëjetojnë (13-18 vjeç) – 2011

Përqindja e fëmijëve Rom që bashkëjetojnë (13-18 vjeç) - 2011




Burimi: Harta Rome (2011) Llogaritjet nga autori

5.4 Dimensionin e katërt - Pjesa që komuniteti Rom zë në të gjithë popullatën përsa i përket martesave të fëmijëve.

Kjo pjesë e studimit është fokusuar në analizën e fenomemit të martesave të fëmijëve në Shoqërinë Shqiptare dhe përqindjen që zë që komuniteti Rom përsa i përket martesave të hershme. Kjo pjesë na tregon të plotë të faktin se komuniteti Rom ka përqind-

jen më të lartë të martesave të hershme. Të dhënat e regjistruara nga popullata shqiptare dhe harta e Romëve, të dyja studime të vitit 2011 dhe ato mund të krahasohen në kuptimin e afatit dhe kontekstit. Ato të dyja kanë të dhëna për statusin e martesor të qytetarëve dhe vecanërisht të fëmijëve poshtë moshës 18 vjeç. Sipas këtyre burimeve të të dhënave (regjistrimit dhe hartës së Romëve 2011) grafiku nr. 14 tregon numrin që fëmijët Rom zënë në të gjithë shoqërinë shqiptare. 21.4% të moshës 15-18 vjeç janë fëmijë Rom në shoqërinë shqiptare, ndërkohë që përqindja më e madhe është në fëmijët e moshës 18 vjeç e llogaritur si 23.4%.

Grafiku 14: Përqindja e fëmijëve Rom që përfaqësojnë në shoqërinë shqiptare- 2011



Burim: Regjistrimi i popullsisë – INSTAT (2011)
Harta Rome (2011) Llogaritjet nga autori


Grafiku nr. 15 tregon në të njëjtën kohë statusin e fëmijëve të martuar në shoqërinë shqiptare, të fëmijëve të komunitetit Rom dhe pjesën që përbën komuniteti Rom në shoqërinë shqiptare. Në qoftë se analizojmë kategorinë e fëmijëve mund të themi se 96.9% e fëmijëve në shoqërinë shqiptare janë beqar, ndërkohë që 75.4% e fëmijëve të

komunitetit Rom janë beqar dhe nga kjo ne mund të themi se 14.7% e fëmijëve beqar në shoqërinë shqiptare janë fëmijë të komunitetit Rom.

Në qoftë se analizojmë martesat e hershme mund të themi se 2.9% e fëmijëve në shoqërinë shqiptare janë të martuar, ndërkohë që 9.1% e fëmijëve në komunitetin Romjanë të martuar. Kjo tregon se 93.5% e fëmijëve të martuar janë fëmijë të komunitetit Rom.

Kategoritë të cilat tregojnë gabime në raportim janë kategoritë e “ të ndarë”, por ligjërisht të martuar” dhe “Fëmijë të divorcuar”. Në kategorinë e parë 11 fëmijë të komunitetit Rom nga 0 fëmijë të shoqërisë shqiptare deklarojnë që janë “të ndarë, por ligjërisht të martuar”. E njëjta gjë ndodh edhe me kategorinë e dytë ku 3 fëmijë të komunitetit Rom nga 3 fëmijë të shoqërisë shqiptare deklarojnë se janë “Fëmijë të divorcuar”. Kjo mbivendosi dhe vlera te larta mund të jenë gjithashtu gabime në raportim, ku fëmijët Rom deklarojnë që janë ligjërisht të martuar ose të divorcuar ndërkohë që ata mund të jenë bashkjetues ose jo ligjërisht të divorcuar ose mund të ketë gabim në numërim dhe intervistim te familjeve.


Grafiku 15: Statusi martesor i fëmijëve – Krahasim midis shoqërisë shqiptare dhe popullatës Rome, 2011



Burim: Regjistrimi i popullsisë – INSTAT (2011) Harta Rome (2011)
Llogaritjet nga autori

Në qoftë se analizojmë vecanërisht kategorinë e fëmijëve beqarë dhe të martuar sipas moshës dhe sa përqind e kësaj kategorie janë fëmijë Rom, sic është praqitur në grafikun nr. 16, 14.7% e fëmijëve beqar janë Rom, ndërkohë që përqindja ulet me kalimin e moshës. Sa më i madh të jetë një fëmijë, aq më e ulët është përqindja e fëmijëve beqar. 17.7% e fëmijëve beqar në moshën 15 vjeç janë fëmijë Rom, ndërkohë që 13.9% e fëmijëve beqar të moshës 18 vjeç janë fëmijë Rom.

Grafiku 16: Përqindja që fëmijët Rom përfaqësojnë në të gjithë shoqërinë shqiptare fëmijët beqar - 2011




Burim: Regjistrimi i popullsisë – INSTAT (2011)

Harta Rome (2011) Llogaritjet nga autori

Grafiku nr. 17 tregon kategorinë e fëmijëve të martuar dhe më specifikisht pjesën që fëmijët e martuar Rom përfaqësojnë në të gjithë shoqërinë shqiptare fëmijët e martuar. Përqindja që fëmijët Rom përfaqësojnë këtë kategori është me të vërtete e lartë, 93.5%. Në qoftë se krahasojmë këtë përfaqësim në grupe të ndryshme ne mund të arrijmë në konkluzionin se në disa grup moshë kjo përqindje kalon vlerën e 100%. Më specifikisht pjesa ku fëmijët Rom të martuar të moshës 16 dhe 17 vjeç, fëmijët e martuar Rom

në moshën 16 dhe 17 vjeçare përfaqësojnë në shoqërinë shqiptare respektivisht 177.3% dhe 118.4%. Këto vlera jo-reale mund të vijnë si rezultat i një raporti jo të mirë- ku fëmijët Rom deklarojnë që janë të martuar ndërkohë që ata nuk janë ligjërisht të martuar por bashkëjetues, ose si rezultat i gabimeve në numërim ose intervistave në familjet gjatë regjistrimit të popullatës shqiptare ose asaj Rome.

Grafiku 17: Përqindja që fëmijët e martuar Rom paraqesin, përfaqësojnë fëmijët e martuar në të gjithë shoqërinë shqiptare. – 2011



Burim: Regjistrimi i popullsisë – INSTAT (2011) Harta Rome (2011)
Llogaritjet nga autori

6. Analiza e martesave të Hershme në Komunitetin Rom në Shkozë, në zonën e Liqenit dhe zona e Tufinës- Studim Rasti

Për shkak se ky studim është fokusuar në martesat e hershme dhe fokus i veçantë i është dhënë Komunitetit Rom, zonat pilote të këtij projekti ishin 3 (tre) Komunitetet Rome në rajonin e Tiranës, dhe respektivisht në Komunitetet Rome vendosura ne Shkoze,

zona e Liqenit dhe zona e Tufinës. Aktivitetet në këto komunitete janë realizuar në formë të takimeve të hapura dhe fokus grupeve pjesë e të cilave ishin meshkuj dhe femra të të dy gjinive dhe moshave të ndryshme nga këto komunitete. Gjatë këtyre takimeve Observatori për të Drejtat e Fëmijëve ka përdorur një formular pyetësori, intervista ku pjesëmarrësit mund të mësojnë më shumë për fenomenin e martesave të hershme në këto komunitete. Qëllimi i takimeve ishte të identifikojë rastet e nuseve dhe dhenderave të rinj, nënat dhe baballarët të cilët kanë qenë të martuar në një moshë shumë të re, para moshës 18 vjeç.

Gjate aktiviteve rezultatet e arritura ishin:

Komuniteti Rom u vendos në këto 3 (tre) zona pilote, të ardhur nga vende të ndryshme të Shqipërisë, si: Kavaja, Korca, Rrogozhina, Elbasani, Peqini, Berati, Bilishti dhe Tirana.

Realizimi i 8 takimeve nga të cilat ne morëm 60 pyetësorë të plotësuar, respektivisht:

- 3 takime në zonën e Shkozës ku u plotësuan 19 pyetësorë;
- 2 takime në zonën e Liqenit ku u plotësuan 22 pyetësorë;
- 3 takime në zonën e Tufinës ku u plotësuan 19 pyetësorë
- Pyetësorët u plotësuan nga:
- **21 burra** (5 në zonën e Shkozës, 10 në zonën e Liqenit dhe 6 në zonën e Tufinës);
- **39 gra** (14 në zonën e Shkozës, 12 në zonën e Liqenit dhe 13 në zonën e Tufinës);

Në momentin e intervistimit shumë nga të intervistuarit ishin më të vjetër se 18 vjeç, dhe kishin qënë të martuar/ ose kishin bashkjetuar që në moshë të re. Duke folur për 60 të intervistuarit të cilët ishin martuar ose bashkjetuar në moshë të re, 44 prej tyre në momentin e intervistës ishin më të mëdhenj se 18 vjeç dhe vetëm 16 prej tyre ishin poshtë 18 vjeç. Respektivisht

- Nga 19 të intervistuar në zonën e Shkozës 10 ishin mbi 18 vjeç dhe 9 ishin nën 18 vjeç;
- Nga 22 të intervistuar në zonën e Liqenit, 17 ishin mbi 18 vjeç dhe 5 ishin nën 18 vjeç;

- Nga 19 të intervistuar në zonën e Tufinës, 17 ishin mbi 18 vjeç dhe 2 ishin nën 18 vjeç;


Nga 60 të intervistuar, 75% prej tyre (45 të intervistuar) nuk kishin qënë asnjëherë në shkollë, pjesa tjetër 25% kishin ndjekur disa vite arsimin e detyrueshëm dhe vetëm 2 prej tyre kishin ndjekur 8 vjet arsimin e detyrueshëm.

Gjatë takimeve të hapura dhe fokus grupet ndryshimet e hasura ishin:

- Disa individë të komunitetit Rom refuzuan të ishin pjesë e këtyre takimeve;
- Në zonën e Liqenit disa familje të komunitetit Rom refuzuan të plotësonin pyetësorët.

Dyzet e katër (44) të intervistuarit në momentin e intervistës ishin mbi moshën 18 vjeç, dhe një nga pyetjet e pyetësorëve ishte rreth moshës në të cilën ato martohen ose fillojnë bashkëjetesën. Rezultatet për këtë pyetje janë treguar në grafikun nr.18, nga ku mund të themi se shumë nga të intervistuarit ishin të martuar ose bashkëjetonin në moshën 17 vjeç në të tre zonat e pilotuara.


Grafiku 18: Moshë në të cilën të intervistuarit janë të martuar ose bashkëjetojnë-2015



Burimi: Takime të hapura dhe fokus grupe në Komunitetin Rom në zonat e Shkozës, Liqenit dhe Tufinës

Sipas të dhënave të mbledhura dhe bazuar në rezultatet e grafikut nr. 19, mund të themi se nga të intervistuarit ku shumica e tyre ishin gra, ishin martuar në moshën 13 vjeç (9 gra) në moshën 17 vjeç (8 gra), dhe shumë prej meshkujve janë martuar në moshën 17 vjeç (7 meshkuj).

Grafiku 19: Moshë në të cilën të intervistuarit janë të martuar/ bashkëjetojnë të ndarë sipas seksit - 2015




Burimi: Source: Të dhëna të marra nga takimet dhe vizitat në terren të organizuara me Komunitetin Rom në zonën: Shkoza, Liqeni dhe Tufina, 2015

Nga 60 të intervistuar, 59 nga ata deklaruan që janë martuar dhe nga këta 36 prej tyre theksuan që nuk ishin ligjërisht të martuar dhe të celebruar, megjithatë ata e konsideronin dhe deklaroronin veten e tyre si të martuar. Vetëm (1) një nga ata ishte i divorcuar.

Grafiku nr. 20 tregon numrin e fëmijëve që të intervistuarit kanë aktualisht. Numri i fëmijëve ndryshon nga asnjë fëmijë në 7, ku shumica e tyre nuk kanë asnjë fëmijë, 2 dhe 3 fëmijë (12 çdo kategori respektivisht). Nga 60 të intervistuar të vetmit që ishin më pak se 18 vjeç ishin vetëm 4 të Komunitetit Rom dhe kishin fëmijë 1-2 vjeç.

Grafiku 20: Numri i fëmijëve i të intervistuarve aktual - 2015



Burimi: Takime të hapura dhe fokus grupe në Komunitetin Rom në zonat e Shkozës, Liqenit dhe Tufinës

Mosha në të cilën intervistuesit kanë patur fëmijën e tyre të parë, 27 individë ose 47% kanë patur fëmijën e tyre të parë në moshën nën 18 vjeç, ose mund të themi kur vetë prindërit kanë qënë në një moshë mjaft të re.

Të pyetur për planifikimin Familjar, 51 % (ose 31 individë) u përgjigjën se nuk kishin informacion për Planifikimin Familjar, 12% (ose 7 prej tyre) u përgjigjën se kishin informacion për Planifikimin Familjar dhe e praktikonin atë, dhe 37 % (ose 22 individë) kishin informacion por nuk e praktikonin atë.

REFERENCA

CENSUS i Popullatës Shqiptare – INSTAT (2011)

Bitu. N and Morteau. C (2010), *Are the Rights of the Child Negotiable? The Case of Early Marriages within Roma Communities in Romania*, Bucharest, ISBN 978-973-139-143-4

Committee on the Rights of the Child, Sixty-first session, Implementation of the Convention on the Rights of the Child, List of issues concerning additional and updated information related to the consideration of the combined second, third and fourth periodic reports of Albania (CRC/C/ALB/2-4), Written replies of Albania

De Soto H., S. Beddies, and I. Gedeshi (2005) ‘Roma and Egyptians in Albania: From social exclusion to social inclusion’, The World Bank, Washington D.C

De Soto H., S. Beddies, and I. Gedeshi (2005) ‘Roma and Egyptians in Albania: From social exclusion to social inclusion’, The World Bank, Washington D.C

European Roma Rights Center (2011), ERRC Submission to the Joint CEDAW-CRC General Recommendation / Comment on Harmful Practices: Child Marriages among Roma

Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë

INSTAT (2015) – Numri i martesave mbi 20 vjeç dhe numri i popullatës mbi 20 vjeç.

INSTAT (2015) – Numri i martesave për vitin 2013.

INSTAT (2014), Perspektiva Gjinore në Shqipëri – Analiza gjinore e rezultateve të CENSUS-it 2011 të popullsisë dhe banesave.

Living Standards Measurement Survey in Albania (2002, 2005, 2008 & 2012).

Silva de Alwis, Rangita (2008), Child Marriage and the Law - Legislative Reform Initiative Paper Series, New York.

United Nations Population Fund in Albania - UNFPA (2012), *Child Marriage in Albania (Overview)*, Version 1.

UNICEF (2014), Child protection from violence, exploitation and abuse – Child marriage

UNICEF (2011), Roma Mapping 2011

ANEKS:

Foto të ndryshme nga takimet e hapura dhe Fokus grupet në Komunitetin Rom në Shkozë, në zonën e Liqenit dhe zonën e Tufinës



Takime të ndryshme me nënat dhe nuset e reja Komunitetin Rom në Shkozë.



Bashkbisedim me Maradonën, një dhëndërr i ri, në zonën e Liqenit



Takim me mamatë dhe nusët e reja në Tufinë

